



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Bankë-Financë”

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Etleva Bajrami

Prof. Asoc. Dr. Brikena Leka

Prill / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në "Bankë-Financë"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Financë Kontabilitet
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: "Bankë-Financë"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1002, datw 30.09.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 110, datë 14.06.2018 Shkresë MASH Nr. 7243/1 prot, date 22.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 278, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite akademike 4 / semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE dhe 5 PAK Për sa i përket ngarkesës (70 % / 30%)
18	Numri i studentëve:	- 2021-2022; 18 studentë; - 2022-2023; 22 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Bankë-Financë", është hapur në vitin 2009-2010, sipas VKM 1002, datë 30.06.2009. Ky program ofrohet nga Fakulteti i Biznesit i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Programi i studimit Msc në "Bankë-Financë" është riorganizuar dy herë. Programi i studimit është hapur me emertimin Msc në Ekonomi Biznes dhe është riorganizuar me Vendim Senati Nr. 110 datë, 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresë nr. 7243/1, datë 22.08.2018, në Msc Banke - Finance. Programi është riorganizuar deri në 20 % me Vendim Senati Nr. 32, datë 28.03.2022, konfirmuar nga MASR me shkresën Nr. 2085/1 Prot., datë 27.06.2022 dhe ndryshimet kanë hyrë në fuqi në vitin akademik 2022-2023. Programi i studimit Msc në "Bankë-Financë" akreditohet për herë të parë. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës i është dhënë leja për fillimin e veprimtarisë me VKM nr.801, datë 2005. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës është licensuar në datë 29.06.2006. Hapja e Fakultetit të Biznesit, UAMD është bërë me vendim 685, datë 25.08.2010. Në të njëjtin vendim është realizuar edhe riorganizimi i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.10, datë 07.04.2017. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës ka në përbërje pesë fakultete:

- Fakulteti i Biznesit
- Fakulteti i Edukimit
- Fakulteti i Studimeve Profesionale
- Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike
- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

Programi i studimit Msc në "Bankë-Financë" ofrohet nga Fakulteti i Biznesit. Fakulteti i Biznesit është i përbërë nga 5 njësi bazë, ku Departamenti i Financë-Kontabilitetit është njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Msc në "Bankë-Financë".

- Departamenti i Financë Kontabilitetit
- Departamenti i Menaxhimit
- Departamenti i Marketingut
- Departamenti i Shkencave Ekonomike
- Departamenti i Turizmit

Programi i studimit Master i Shkencave në "Bankë- Financë", është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, në fushën financë-bankë. Ky program studimi është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale dy vite akademike (katër semestra). Në përfundim të programit të studimit studenti pajiset me diplomën: Diplomë e ciklit të dytë "Master i Shkencave në Bankë- Financë".

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Në datën 21.01.2022, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin për herë të parë të programit të studimit Msc “Bankë-Financë” i cili ofrohet nga Departamenti Financë Kontabilitet i Fakultetit të Biznesit, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017” ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc. Dr. Brikena Leka, pedagoge në FEUT, Departamenti i Financës, dhe Prof. Asoc. Dr. Etleva Bajrami, pedagoge në FEUT, Departamenti i Financës. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Msc. Majlinda Demirmeli.

Në datën 28.09.2023 ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe agjenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 26 dhe 27 Tetor 2023 në ambjentet e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 07.11.2023. Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Msc në “Bankë-Financë”. Në fund paraqiten rekomandimet për programin e studimit dhe kryhet një analizë SËOT mbi programin e studimit që akreditohet për herë të parë. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 20.03.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 19/56 Prot, datë 20.03.2024. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka dërguar në ASCAL më datë 11.04.2024, nëpërmjet shkresës me Nr. 621/2 prot, datë 04.04.2024 “Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Lidhur me komentin për Standardi II 2 kriteri 2, nuk ka ndryshime në raport.

GVJ është shprehur se *sugjeron që numri i PAE+PAK i kësaj kategorie duhet zgjeruar në funksion të rritjes së cilësisë së programit në fjalë.* GVJ vlerëson që në komentet e Institucionit, thuhet që për vitin akademik 2023-2024, Departamenti ka pësuar ndryshime, ku stafi i kategorisë Profesor ka shkuar në katër dhe dy të tjerë janë në proces të fitimit të titullit Profesor, megjithatë vlerësimi ynë është për periudhën deri në fund të vitit akademik 2022-2023.


2. Lidhur me komentin për, **Standardi II.3, kriteri 2, ka ndryshime në raport**
GVJ ka konsideruar përgjigjen që është dhënë edhe përpara se të përgatitej Draft RVJ-ja, por duke qenë se edhe kur bëhej e njëjta analizë sic na sugjerohet në komente përsëri na rezultonin diferenca në numrin e krediteve, vendosëm të japim vlerësimin si në Draft RVJ.
Duke ju referuar orientimit që ju jepni në Komente, ku përsëri shfaqen probleme lidhur me numrin total të krediteve, **ndryshimi në raport do jetë:**
Referuar planeve mësimor për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023, studentët që kanë filluar vitin e parë me planin mësimor 2021-2022 kanë realizuar 69 kredite në vitin e parë, ndërkohë në planin mësimor 2022-2023 në vit të dytë kanë realizuar 55 kredite, pra 124 kredite (i bie një lëndë të jetë zhvilluar dy herë). Ndërkohë, referuar planeve mësimorë 2020-2021 dhe 2021-2022, studentët që kanë filluar vitin e parë në 2020-2021 kanë zhvilluar 68 kredite në vit të parë dhe 51 kredite në vit të dytë në planin mësimor të 2021-2022, pra në total 119 kredite-më pak se numri i krediteve në kurrikulën e këtij program studimi. GVJ sugjeron që Programet mësimore duhet të përshtaten me Kurrikulën e programeve të studimit, dhe numrin e krediteve përkatës. Ndërkohë **nuk ka ndryshim** në vlerësimin për Standartin Përkatës.
3. Lidhur me komentin për, **Standardi II.3, kriteri 4 nuk ka ndryshime në raport.**
GVJ ka shprehur mendimin që në varësi të lëndës dhe në respektim të lirisë akademike të shikohet mundësia e fleksibilitetit në ndarjen e vlerësimit sipas formave të kontrollit të dijeve.
4. Lidhur me komentin për, **Standardi II.4, kriteri 2 nuk ka ndryshime në raport.**
GVJ konstaton gjithashtu se ka edhe lëndë të cilat nuk lidhen me drejtimin e studimit dhe nuk gjenden në Mastera të të njëjtit drejtim si Drejtim i Avancuar i Projekteve dhe Marketing i avancuar. GVJ konstanton që këto lëndë, pavarësisht se argumentohet në komente që janë konform kategorisë së lëndëve Bazë- Përgatitje metodologjike dhe kulturore të përgjithshme duke i ndihmuar studentët të marrin njohuritë plotësuese në profesionin e tyre në këtë fushë, nuk janë lëndë të formimit bazë për studentë që ndjekin një program Master i Shkencave në Bankë-Financë.
Ky konstatim i GVJ-së u mbështet edhe nga stafi akademik i këtij program studimi, në takimin që pati me ta.
5. Lidhur me komentin për, **Standardi II.4, Kriteri 3 si dhe në konkluzione ka ndryshime në raport si:** Në tabelat e depozituara nga institucioni në Planet mësimore ka mospërputhje të numrit të krediteve me kurrikulën e programit (sqaruar në Standartin II.3, Kriteri 2). **Nuk ka ndryshim** në vlerësimin për Standartin Përkatës.
6. Lidhur me komentin për **Standardin II.4, Kriteri 6 nuk ka ndryshime në raport.**
GVJ ka argumentuar në Draft RVJ që për një program Master i Shkencave në Bankë-Financë ka shumë lëndë në fushën e kontabilitetit. Kuptojmë rëndësinë e lëndëve të kontabilitetit. Është kjo arsyeja që ofrohen Mastera Shkencor dhe Profesional me Drejtim Kontabël.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Bankë-Financë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>UAMD ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruajë vlerat akademike kulturore kombëtare. UAMD vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtari krijuese dhe profesionale. Në Nenin 2 të Statutit perifrazohet se Statuti i UAMD-së bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”.</p> <p>Rregullorja e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, në nenin 2 përcakton bazën ligjore mbi të cilën është hartuar dhe rregullon aktivitetin e institucionit, të cilat janë: Kushtetuta e Shqipërisë, Ligji i arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, Kodin e procedurave administrative, Kodin e punës, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.pdf Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Bankë-Financë” synon formimin e profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën e Bankës dhe Financës të cilat do të jenë të aftë të përballen me sfidat kombëtare dhe globale (Rregullore e programit të studimit Msc në Bankë-Financë). Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. Në nenin 3 të Statutit jepet misioni i institucionit që është të krijojë, zhvillojë dhe përcjellë dije përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të formojë specialist të lartë dhe shkencëtarë të rinj. Të zhvillojë të menduarit kritik dhe analitik, të kultivojë përgjegjësi dhe</p>

	<p>angazhim ndaj njeriut. UAMD ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë. Institucioni ka për qëllim të përgatisë specialist për tregun e punës shqiptar dhe ndërkombëtar, të formojë shkencëtar të rinj, të realizojë kualifikime shkencore të stafit akademik, etj.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Në <i>nenin 4</i> të Rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në "Bankë-Financë" theksohet se misioni i programit të studimit synon formimin e profesionistëve dhe studiuesve në fushën e bankës dhe financës. Programi ka si qëllim të pajisë studentët me njohuri teorike bazë, aftësim në metodat e kërkimit në fushat e financës dhe bankës. Kjo veprimtari realizohet me anë të arsimit dhe kërkimit shkencor, në përputhje me Statutin e institucionit që qartëson se universiteti ushtron veprimtarinë në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale (neni 1, pika 2).</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në "Bankë-Financë" ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të Planit të zhvillimit strategjik 2020-2025, ku në pikën IV jepet se shkenca ekonomike (biznesi, financë kontabiliteti, menaxhimi, turizmi dhe marketingu) ofrohet në larminë e programeve të studimit nëpërmjet të cilëve mundësohen prioritetet dhe objektivat e institucionit. Programi i studimit Master i Shkencave në "Bankë-Financë" është program i ciklit të dytë të studimit me kohëzgjatje 2 vjeçare dhe 120 ECTS, në përputhje me Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, neni 43, pika 2.</p> <p><i>Evidencë 4_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale</p>	<p>Sipas Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, neni 30, institucioni kryen veprimtari shkencore bazë ose të zbatuar, studime, projekte, etj, që synojnë rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimit të vend. UAMD me anë të programit të studimit ka për qëllim të përgatisë specialist për tregun e punës shqiptar dhe ndërkombëtar, të formojë shkencëtar të rinj, të</p>




<p>të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>realizojë kualifikime shkencore të stafit akademik, etj. Programi i studimit zhvillohet në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të Arsimit të lartë, e cila synon arsim të lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.</p> <p><i>Evidencë 6_Stategjia Kombëtare e Arsimit, v.a 2021-2026.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UAMD ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruajë vlerat akademike kulturore kombëtare. UAMD vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtari krijuese dhe profesionale.</i> - <i>Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</i> - <i>Programi i studimit zhvillohet në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit të Arsimit të lartë, e cila synon arsim të lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për</p>	<p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" në Durrës i hapur me Vendim Nr. 801, Datë 20.12.2005 për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës, është institucion i konsoliduar me një përvojë shumë vjeçare në ofrimin e programeve të studimit në arsimin e lartë. Personeli akademik është i kualifikuar dhe me përvojë, dhe</p>

<p>ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>një numër i tyre janë me tituj dhe grada shkencore. UAMD ka kapacitete infrastrukturore për të realizuar aktivitetet edukative dhe kërkimore shkencore. UAMD ka ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e proceseve mësimore, kërkimore, laboratorike, etj. Fakulteti i Biznesit, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 138 pedagogë, nga të cilët 69 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 69 pedagogë me kontratë (PAK). Departamenti i Financë-Kontabilitetit që ofron këtë program studimi ka 16 personel akademik efektiv, nga të cilët 12 personel akademik janë me grada dhe tituj dhe 26 personel akademik me kontratë nga të cilët 12 janë me grada dhe tituj, duke mundësuar mësim dhe kërkim shkencor cilësor.</p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në “Bankë-Financë” është në përputhje me fushën akademike të ofruar nga Fakultetit i Biznesit që është shkenca ekonomike (biznesi, financë kontabiliteti, menaxhimi, turizmi dhe marketingu). Programi i studimit përmban lëndë të cilat mundësojnë formimin e specialistëve në fushën e bankës dhe financës.</p> <p>Fakulteti i Biznesit përbëhet nga 5 njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Departamenti i Financë-Kontabilitetit ➤ Departamenti i Marketingut ➤ Departamenti i Menaxhimit ➤ Departamenti i Shkencave Ekonomike ➤ Departamenti i Turizmit <p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, sipas VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë”, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>
	<p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 25_Kodifikimet e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti Financë Kontabilitet.pdf</i></p>

<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Njësia bazë ose departamenti zhvillon mësimdhënien dhe punën kërkimore shkencore, në fusha të përafërta kërkimi dhe grupon disiplinat kërkimore. Në <i>nenin 21</i>, Rregullores së Departamentit të Financë-Kontabilitetit shprehet se departamenti kryen veprimtari kërkimore shkencore, ekspertizë shkencore, projekte, etj me synim të rritjes së cilësisë së arsimit të lartë dhe zhvillimit të vendit. Kërkimi shkencor realizohet në përputhje me fushat e financës dhe bankës. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të departamentit, që synon formimin e profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën e bankës dhe financës. Programi ka si objektiv të pajis studentët me njohuri bashkëkohore shkencore në disiplinat e bankës dhe financës (neni 4 i Rregullores së Masterit Shkencor në Bankë-Financë). Ky program ofrohet nga Departamenti Financë-Kontabilitet i Fakultetit të Biznesit të UAMD.</p> <p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Në dokumentin ALUMNI NETWORK BF, në vision përshkruhet se Fakulteti i ndihmon ish-studentët përmes ofrimit të mundësive për internship-e, me referenca për punësim, angazhim në projektet e universitetit, etj. Njoftime të ndryshme për trajnime, internship-e, mundësi punësimi publikohen në faqen zyrtare dhe rrjete sociale të UAMD. Me anë të marrëveshjeve njësia kryesore përgjegjëse për programin i ndihmon ish-studentët me shpërndarje të informacioneve si dhe mundësi punësimi në sektorin publik dhe privat. Alumni-t e mbështesin universitetin me opinionet e tyre në lidhje me tregun e punës, me mundësitë e përditësimit të literaturës dhe në zhvillimin e praktikës mësimore.</p> <p><i>Evidencë 39_Alumni Network FB Raport.pdf</i></p>

Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UAMD ka kapacitete infrastrukturore për të realizuar aktivitetet edukative dhe kërkimore shkencore. UAMD ka ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e proceseve mësimore, kërkimore, laboratorike, etj;</i> - <i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të departamentit, që synon formimin e profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën e bankës dhe finances;</i> - <i>Alumni-t e mbështesin universitetin me opinionet e tyre në lidhje me tregun e punës, me mundësitë e përditësimit të literaturës dhe në zhvillimin e praktikës mësimore;</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në Kreun II, neni 10 i Rregullores së Universitetit “Aleksandër Moisiu” përcaktohen njësitë përbërëse të UAMD. Në nenin 11 përcaktohet se Struktura e përgjithshme e institucionit si dhe numri i personelit në të gjitha nivelet propozohet nga Senati Akademik dhe miratohet nga Bordi i Administrimit. Në nenin 12 jepet funksioni, detyrat dhe përgjegjësitë e Senatit akademik dhe në vijim nga neni 12 deri në nenin 21 jepen strukturat drejtuese, detyrat dhe përgjegjësitë në nivel organizimi akademik qëndror.</p> <p>Në seksionin e II të Rregullores së Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës jepet organizimi në nivel njësie akademike kryesore, si edhe funksionet, dhe përgjegjësitë e Asamblesë së personelit akademik. Jepen funksioni dhe përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë kryesore si kordinator i veprimtarisë së njërive bazë, etj dhe dekanatit, ku ky i fundit harton dhe miraton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, shqyrton</p>

	<p>analizën vjetore mësimore dhe kërkimore, etj. (neni 24, 25, 26 i Rregullores së Universitetit “Aleksandër Moisiu”).</p> <p>Në nenin 27 jepet funksioni, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë bazë. Drejtuesi i njësisë bazë mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën dhe mënyrën e duhur, etj nëpërmjet një qartësie të ndarjes së detyrave të strukturave drejtuese dhe funksionale mundësohet një marrëdhënie e frytshme bashkëpunimi brenda institucionit.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve në Planin Strategjik të Departamenti “Financë - Kontabilitet” 2021– 2025, prioriteti 3 është krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit me institucionet bankare dhe biznese të ndryshme në shërbim të ndërtimit të urave lidhëse midis universitetit dhe biznesit. Bashkëpunim të ndërsjelltë me kompanitë e sigurimit dhe fondet e investimit dhe marrëveshje bashkëpunimi me departamente homologe brenda dhe jashtë vendit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Një nga prioritetet e UAMD të vendosura në Planin e zhvillimit strategjik 2020-2025 është ndërkombëtarizimi. UAMD synon që Universiteti të jetë një aktor i rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik të qytetit dhe rajonit rritja e partneriteteve midis insitucioneve të huaja të arsimit të lartë. Gjithashtu, objektiv strategjik është edhe zhvillimi, bashkëpunimi dhe nxitja e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik, ndërkombëtar nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe. Institucioni zhvillon leksione të hapura dhe aktivitete si rezultat i bashkëpunimeve të vazhdueshme me aktorë të ndryshëm. UAMD synon rritjen e numrit dhe cilësisë në zbatim të projekteve zhvillimore, në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë, inovacionit dhe transferimit të teknologjive.</p> <p><i>Evidencë 27_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 4_Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, 2020-2025.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 36_Leksionet e hapura dhe aktivitetet e Departamentit Financë Kontabilitet, v.a 2021-2022.pdf</i></p>

<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Praktikat mësimore janë një element i rëndësishëm i programit të studimit Master i Shkencave në “Bankë-Financë”. Praktika mësimore ndërthur konceptet teorike të mësuara me praktikën dhe ndihmon studentët të kuptojnë më mirë teorinë dhe se si Teoria përdoret në praktikë.</p> <p>Për realizimin e praktikës mësimore dhe programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje dypalëshe me partner dhe institucione të rëndësishme për zhvillimin e aktivitetit, misionit dhe qëllimit të institucionit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni rezultojnë 143 marrëveshje me partnerë në fushën e arsimit të lartë, banka dhe institucione të tjera. Një nga synimet e lidhjes së marrëveshjeve është zhvillimi i praktikave të studentëve, zhvillimi i internship-eve, zhvillimi i leksioneve të hapura me ekspertë nga fusha e finances dhe bankës. Nëpërmjet lidhjeve të marrëveshjeve mundësohet edhe përditësimi i informacionit në lidhje me tregun e punës, kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e krijuara për studentët.</p> <p><i>Evidencë 35_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit me bizneset.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 27_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit janë të rëndësishme për zhvillimin e praktikave mësimore, për zhvillimin e detyrave dhe projekteve, për punësim të studentëve gjatë dhe pas studimeve.</p> <p>Alumni-t e mbështesin universitetin me opinionet e tyre në lidhje me tregun e punës, me mundësitë e përditësimit të literaturës dhe në zhvillimin e praktikës mësimore. GVJ konstaton se Institucioni disponon Raport të rjetit të Alumnit të Fakultetit të Biznesit. Në këtë raport jepen të dhëna mbi arritjet dhe punësimin e ish studentëve duke dhënë informacion edhe për bashkëpunimet. Departamenti i Financë-Kontabilitetit harton Analizën e marrëveshjeve të bashkëpunimit, me synim të të kuptuarit të arritjeve dhe të mundësive për përmirësim në të ardhmen.</p> <p><i>Evidencë 39_Alumni Network FB Raport.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 45_Analiza e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023.pdf</i></p>

Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UAMD ka prioritet ndërkombëtarizimin dhe synon që Universiteti të jetë një aktor i rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik të qytetit dhe rajonit, rritjes së partneriteteve midis institucioneve të huaja të arsimit të lartë;</i> - <i>Për realizimin e praktikës mësimore dhe programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje dypalëshe me partner dhe institucione të rëndësishme për zhvillimin e aktivitetit, misionit dhe qëllimit të institucionit;</i> - <i>Nëpërmjet lidhjeve të marrëveshjeve mundësohet edhe përditësimi i informacionit në lidhje me tregun e punës, kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e krijuara për studentët. UAMD synon rritjen e numrit dhe cilësisë në zbatim të projekteve zhvillimore, në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë, inovacionit dhe transferimit të teknologjive;</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në	Programi i studimit Masteri i Shkencave në Bankë-Financë ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”. Programi i studimit organizohet dhe ka kohëzgjatje prej 2 vitesh studimit me 120 ECTS në total. Lëndët janë të shprehura në kredite ECTS. Në

<p>përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>planin mësimor sipas Veprimtarive Formuese lëndët janë paraqitur të ndara sipas tipit të veprimtarisë, në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplimore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, në përputhje me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.</p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit synon formimin e shprehive dhe profesionalizmit në fushën e financës dhe bankës. Lëndët e përfshira synojnë të kompletojnë me njohuri dhe kompetenca profesionale në fushën e bankës dhe financës që është edhe qëllimi i këtij programi mësimor.</p> <p>Në lëndët bazë të programit për të zhvilluar kompetenca të avancuara kërkimore tek studentët përfshihet lënda Ekonometri (pas Riorganizimit të vitit 2022), e cila jep njohuri për zhvillimin e mikrotezave dhe studimeve të thelluara.</p> <p>Në lëndët Karakterizuese lëndët ofrojnë njohuri dhe kompetenca në fushën e financës, kontabilitetit dhe menaxhimin e riskut.</p> <p>Në lëndët ndërdisiplinore ka lëndë nga fusha të tjera studimi si E drejta Bankare dhe e Sigurimeve dhe fusha e Kontabilitetit, ku në lëndët ndërdisiplinore janë përfshirë 3 lëndë kontabiliteti.</p> <p>Njohuritë e fituara kompletojnë të diplomuarin me aftësi vendimmarrëse të nevojshme në fushën e financave të biznesit dhe bankës. Studentët marrin njohuri të vlefshme për të qenë profesionistë në tregun e punës.</p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë ka të përfshirë Praktikë profesionale. Plani mësimor jepet sipas 3 viteve të fundit në tabelën 10 të tabelave të vendosura në dispozicion nga institucioni. Në tabelën 9, jepet plani mësimor sipas veprimtarive formuese. Ka ndryshime në lëndët e paraqitura në tabelat 9 dhe 10.</p> <p><i>Lënda Drejtim Bankar i Ndërmjetëm e paraqitur si lëndë e veprimtarisë karakterizuese në tabelën 9 mungon në Planin mësimor të 2022-2023 në tabelën 10. Plani mësimor i vitit akademik 2022-2023 ka një total prej 115 kreditesh ECTS dhe</i></p>

	<p><i>jo 120 ECTS, në tabelën 10. Ndërsa në dy vitet e mëparshme totali i krediteve janë 120 ECTS.</i></p> <p><i>Po në Planin mësimor të vitit 2022-2023, lënda Ekonomiks Manaxherial në Planin mësimor në tabelën 10 ka 4 kredite ECTS, dhe shoqërohet me simbolin A. Në këtë Plan mësimor ka 4 lëndë të Lëndëve bazë me një total prej 16 kreditesh ECTS duke tejkaluar maksimumin 10% e krediteve të lëndëve bazë. Në Planin mësimor të riorganuar për vitin 2022-2023 lënda Ekonomiks Manaxherial nuk është pjesë e këtij programi, ndërkohë që ajo është zhvilluar në këtë vit akademik në kategorinë e Veprimtarive formuese (referuar Tabelës 9). Lëndët bazë janë 3 dhe kanë 12 ECTS dukë përbërë 10% të totalit të krediteve.</i></p> <p><i>Programi i studimit zhvillohet në dy vite akademike, me total 120 kredite ECTS. Çdo lëndë ka të përcaktuar kreditet.</i></p> <p><i>Lëndët karakterizuese (B) janë 9 dhe kanë nga 7 kredite ECTS secila me një total 63 kredite ECTS të cilat përbëjnë 52,5% të krediteve për planin mësimor të vitit akademik 2022-2023 sipas Relacionit per Riorganizimin dhe Veprimtaritë formuese, tabela 9.</i></p> <p><i>Ndërsa në Planin mësimor 2023-2023 janë vetëm 6 lëndë karakterizuese me një total prej 42 ECTS (35% të krediteve duke qenë nën minimum).</i></p> <p><i>Ndërsa Lëndët Ndërdisciplinore © janë 4 dhe kanë nga 5 kredite ECTS secila, me total 20 kredite ECTS, 16,6 % të krediteve duke tejkaluar maksimumin e krediteve të lëndëve të veprimtarisë C. Në Planin mësimor të Rregullores së studimit në Aneksin II, është specifikuar që duhet të zgjidhen vetëm 4 lëndë nga Lëndët Ndërdisciplinore të paraqitura, ndërkohë rezulton se në vitin akademik 2022-2023 janë zhvilluar 5 lëndë nga kjo kategori.</i></p> <p><i>Praktika profesionale ka të përcaktuara kreditet, 12 kredite ECTS, 10% të krediteve ECTS. Mikroteza ka 13 kredite ECTS që përbëjnë 10, 83% të totalit të krediteve në përputhe me legjislacionin në fuqi.</i></p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf, Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20_, 2022-2023.pdf</i></p>
--	--




<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>N/A</p>




<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Sikurse theksohet edhe në RVB ky program studimi nuk ka ngjashmëri në emërtesë me programe studimi të ciklit të dytë Master të ofruara në të njëjtën fushë. Ndërkohë që ka ngjashmëri në përmbajtje, në lëndë me programe Master që ofrohen në të njëjtën fushë.</p> <p><i>RVB Msc Bankë- Financë.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 21_Kurrikula të ngjashme me IAL të tjera.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Institucioni ndodhet shkresa e drejtuesit të njësisë bazë drejtuar Dekanit të Fakultetit të Biznesit ku janë vendosur kodet e programeve të studimit që ofrohen nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit në përputhje me Udhëzimin nr.31, dt. 15.11.2022 “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kodi për këtë program studimi është 72MS0412S. Nuk ka të dhëna nëse ky kod është i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p><i>Evidencë 25_Kodifikimet e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti Financë Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit i Fakultetit të Biznesit, UAMD.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>Njohuritë e fituara kompletojnë të diplomuarin me aftësi vendimmarrëse të nevojshme në fushën e financave të bizneseve dhe bankave. Studentët marrin njohuri të vlefshme për të qenë profesionistë në tregun e punës;</i></p> <p><i>Programi i studimit zhvillohet në dy vite akademike, me total 120 kredite ECTS. Çdo lëndë ka të përcaktuar kreditet;</i></p>

	<p><i>Ndërsa në Planin mësimor 2023-2023 janë vetëm 6 lëndë karakterizuese me një total prej 42 ECTS (35% të krediteve duke qenë nën minimum);</i></p> <p><i>Plani mësimor i vitit akademik 2022-2023 ka një total prej 115 kreditesh ECTS në tabelën 10;</i></p> <p><i>Gjatë vitit akademik 2022-2023, është zhvilluar lënda “Ekonomiks manaxherial” e cila nuk është pjesë e programit mësimor, pas riorganizimit. Gjthashtu, rezulton se në vitin akademik 2022-2023 janë zhvilluar 5 lëndë nga kategoria Lëndët Ndërdisciplinore, kur sipas programit të miratuar duhet të zgjidhen vetëm 4 lëndë;</i></p> <p><i>Ky program studimi ka ngjashmëri në përmbajtje, në lëndë me programe Master që ofrohen në të njëjtën fushë;</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, dhe VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.</p> <p>Fakulteti i Biznesit përbëhet nga 5 njësi bazë (Rregullore e Fakultetit të Biznesit, neni 5):</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Departamenti i Financë-Kontabilitetit; ➤ Departamenti i Marketingut; ➤ Departamenti i Menaxhimit; ➤ Departamenti i Shkencave Ekonomike; ➤ Departamenti i Turizmit;

Programi i studimit Masteri i Shkencave në Bankë Financë është pjesë e Ciklit të Dytë të Studimeve në strukturën akademike të Departamentit të Financë Kontabilitetit, në Fakultetin e Biznesit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Ky program është i nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (*Rregullore Programi Studimi Masteri i Shkencave në Bankë-Financë*).

Përgjegjësia për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Bachelor “Bankë-Financë” është e përcaktuar në Statut dhe Rregulloret përkatëse. Strukturat përgjegjëse janë Rektori, Dekanati dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit. Struktura mbështetëse janë Departamenti i Shkencave Ekonomike, Departamenti i Menaxhimit dhe Departamenti i Marketingut i Fakultetit të Biznesit të UAMD. Në Fakultetin e Biznesit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, të cilët paraqiten në Aneks, Tabelat Përmbledhëse, tabela 1. janë si vijon:

Personeli akademik pranë Fakultetin e Biznesit, UAMD		
Grada/titulli	PAE	PAK
Prof.Dr	5	7
Prof.Asoc.	13	11
Dr.	40	13
Dr. në proces	11	3
Msc	-	35
Gjithsej	69	69

Po në Aneks, Tabelat Përmbledhëse, tabela 1, jepen të dhënat mbi personelin akademik për vitin 2022-2023. Pranë Departamentit të Financë-Kontabilitetit janë të angazhuar 16 personel akademik efektiv dhe 26 personel akademik me kontratë, tabela 2 si vijon:

Personeli akademik pranë Departamentit të Financë - Kontabilitetit		
Grada/titulli	PAE	PAK
Prof.Dr	1	2
Prof.Asoc.	1	5

Dr.	10	5
Dr. në proces	4	-
Msc	-	14
Gjithsej	16	26

Për realizimin e procesit mësimor në programin Master i Shkencave në Bankë-Financë janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, tabela si vijon:

Personeli akademik për programin e studimit Master i Shkencave në Bankë Financë						
Titulli/Grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1	2	1	2	1	1
Prof.Asoc.	1	2	0	2	0	2
Dr	9	1	10	1	11	1
Dr. në proces	0	0	2	0	3	0
Msc	2	0	0	1	0	1
Gjithsej	13	5	13	6	15	5

Raporti PAE/PAK për vitin 2022-2023 është 15/5.

GVJ konstanton që personeli akademik i kategorisë “Profesor” i angazhuar në këtë program studimi është relativisht i ulët.

GVJ sugjeron që numri i PAE+PAK i kësaj kategorie duhet zgjeruar në funksion të rritjes së cilësisë së programit në fjalë.

Tabela 6.1 dhe tabela 7 kanë të dhëna të ndryshme në lidhje me stafin akademik të angazhuar në program për vitin akademik 2020-2021. GVJ i është referuar Tabelës 7.

Tabela Ascal_MSC BF.pdf

Evidencë 95_Personeli akademik i Fakultetit të Biznesi-t me tituj dhe grada.pdf

	<p><i>Evidencë 96.1_Të dhëna për programin e studimit MSc BF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 96_Departamenti Financë-Kontabilitet - Titujt dhe Gradat në vitet 2018-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Kordinatori i Programit të studimit Master i Shkencave në Bankë -Financë, është përgjegjës për zhvillimin dhe ecurinë e programit dhe praktikave profesionale (Rregullore e Programit të Studimit BF). Në fakultetin e Biznesit janë të punësuar 10 personel ndihmës- akademik me karakter administrative dhe 2 personel ndihmës-akademik (laborantë), të cilët mbështesin stafin akademik dhe studentët gjatë realizimit të proceseve akademike.</p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e kordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në Rregulloren e Departamentit Financë-Kontabilitet, në Kreun II ku jepet Struktura organizative e departamentit të finance-kontabilitetit, në nenin 7, përcaktohet se pjesë e organeve dhe autoritetet drejtuese të Departamentit të Financë-Kontabiliteti është edhe Koordinatori i programit të studimit. Koordinatori i Programit të studimit ka rol kyç në sigurimin e cilësisë së programeve të studimit dhe siguron garantimin e suksesit të studentëve (<i>Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet, neni 15</i>).</p> <p>Koordinatori i programit të studimit raporton pranë Dekanit dhe Drejtuesit të njësisë bazë mbi cilësinë dhe standartet që mbikëqyr. Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme studimin e tregut mbi programin e studimit që mbikëqyr. Koordinon punon për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik, programeve lëndore (syllabuset), paketën e praktikës profesionale dhe të udhëzimeve për temën e Diplomimit, etj.</p> <p>Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka përzgjedhur kordinatorët e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë për të cilët është përgjegjës, ndërmjet të cilëve është përzgjedhur edhe kordinatorja e programit të studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë.</p>

	<i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i> <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Përgjegjësia për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Bachelor "Bankë-Financë" është e përcaktuar në Statut dhe Rregulloret përkatëse. Strukturat përgjegjëse janë Rektorati, Dekanati dhe Departamenti i Financë Kontabilitet.</i> - <i>GVJ konstanton që personeli akademik i kategorisë "Profesor" i angazhuar në këtë program studimi është relativisht i ulët. GVJ sugjeron që numri i PAE+PAK i kësaj kategorie duhet zgjeruar në funksion të rritjes së cilësisë së programit në fjalë.</i> - <i>Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka përzgjedhur kordinatorin e programit të studimit Master i Shkencave Bankë Financë i cili përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme studimin e tregut mbi programin e studimit që mbikëqyr.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Dokumentat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor janë të plota. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit disponon Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, Rregulloren e Programit të studimit, Rregulloren e Departamentit të Financë-Kontabilitetit, Planin strategjik të Departamentit të Financë-Kontabilitetit, Planin mësimor, kurrikulën e programit të studimit, syllabuset e lëndeve, etj.

	<p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf, Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 11_Plani Strategjik, Fakulteti i Biznesit, 2021-2025.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. Programi i ciklit të parë të studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë organizohet me 120 kredite europiane (ECTS) me kohëzgjatje dy vjeçare.</p> <p>Referuar planeve mësimor për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023, studentët që kanë filluar vitin e parë me planin mësimor 2021-2022 kanë realizuar 69 kredite në vitin e parë, ndërkohë në planin mësimor 2022-2023 në vit të dytë kanë realizuar 55 kredite, pra 124 kredite (i bie një lëndë të jetë zhvilluar dy herë). Ndërkohë, referuar planeve mësimore 2020-2021 dhe 2021-2022, studentët që kanë filluar vitin e parë në 2020-2021 kanë zhvilluar 68 kredite në vit të parë dhe 51 kredite në vit të dytë në planin mësimor të 2021-2022, pra në total 119 kredite- më pak se numri i krediteve në kurrikulën e këtij program studimi. <i><u>GVJ sugjeron që Programet mësimore duhet të përshtaten me Kurrikulën e programeve të studimit, dhe numrin e krediteve përkatës.</u></i></p> <p>Orët totale në auditor për Programin e studimit Master i Shkencave në Bankë – Financë janë 1119 orë, ndërsa orët jashtë auditorit janë 1756 orë më total. Orët në auditor / orët jashtë auditorit = $1119/1756 = 39\%$ e orëve zhvillohen në auditor dhe 61% jashtë auditorit.</p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>

<p>specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në nenin 38 dhe 39 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit UAMD, jepen procedurat dhe kriteret e pranimit në Programet e ciklit të dytë të studimeve dhe planifikimi i kuotave. Kreu II, neni 9 në Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë, jepen kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve në Msc Bankë-Financë. Pranimi i kandidatëve bëhet në bazë të kriterëve të pranimit që janë vendosur nga njësia bazë në fillim të vitit akademik. Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimin e barazisë, drejtësisë, paanësisë dhe meritës. Në rregullore përcaktohen edhe dokumentet që duhet të dorëzojnë kandidatët.</p> <p>Neni 10 i Rregullores së Programit të Studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë, dhe neni 47 i Rregullores së Fakultetit të Biznesit shprehen mbi mundësitë e transferimit, kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve, etj. Transferimet mundësohen në të njëjtin cikël studimi e në fusha studimi të njëjtë, ose të ngjashme.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 65_Kritere Pranimi programet e studimit ndër vite.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Neni 52 Kurrikula (Plani mësimor) i Rregullores së Fakultetit të Biznesit jep të dhëna të detajuara mbi ndërtimin e planit mësimor, veprimtaritë formuese të lëndëve të planit mësimor, ndarjen e lëndëve në lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje.</p> <p>Syllabusi (neni 53 i Rregullores së Fakultetit të Biznesit) është programi i lëndës në të cilin parashikohen objektivat e lëndës, literatura e detyrueshme e miratuar në Departament, literatura e sugjeruar për informacion shtesë, temat, orët për leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, seancat e praktikave profesionale, kohëzgjatjen e lëndës, rregullat e provimit (të cilat janë të specifikuar në rregulloren e provimeve të fakultetit) dhe të mënyrave të vlerësimit (Rregullorja e Fakultetit të Biznesit, UAMD, neni 59).</p> <p>GVJ konstaton që format e kontrollit të dijeve janë të unifikuara: 10% e pikëve të vlerësimit total lidhen me plotësimin e detyrimeve të vazhdueshme (laboratorë, detyra kursi, etj), ndërkohë 90% e pikëve lidhen me dy provime në lëndë: 40% të vlerësimit përfundimtar nga një provim i ndërmjetëm dhe 50% të vlerësimit përfundimtar nga provimi final.</p>




	<p><i>GVJ sugjeron që në varësi të lëndës dhe në respektim të lirisë akademike të shikohet mundësia e fleksibilitetit në ndarjen e vlerësimit sipas formave të kontrollit të dijeve.</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 108_Syllabuse sem 2_v.a. 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 52_Syllabus ne anglisht_MSc BF.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p> <p>Neni 77 i Statutit shpreh se UAMD harton politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë. Njësia bazë realizon vlerësimin e brendshëm të programit të studimit (Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë, neni 7). Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë është objekt i rishkimit periodik. Gjatë takimit me stafin gjatë vizitës në institucion, u theksua fakti që lëndët janë objekt i diskutimeve të vazhdueshme në mbledhjet e Departamentit me fokus përditësimin dhe përshtatjen me tregun. Ndërkohë GVJ nga shqyrtimi i dokumentave shoqëruese të RVB dhe nga takimet gjatë vizitës në Institutacion konstaton që është bërë riorganizim i këtij program studimi në vitin 2020 dhe sërish në 2022.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i> <i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i> <i>Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20_, 2022-2023.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit disponon rregulloret e nevojshme në nivel institucioni dhe programi.</i> - <i>Viti akademik organizohet në semestra, sezone provimesh, module/sezon vere. Kohëzgjatja e një semestri është jo më shumë se 16 javë.</i> - <i>Pranimi i kandidatëve bëhet në bazë të kriterëve të pranimit që janë vendosur nga njësia bazë në fillim të vitit akademik. Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimin e barazisë, drejtësisë, paanësisë dhe meritës.</i> - <i>GVJ konstaton që format e kontrollit të dijeve janë të unifikuara: 10% e pikëve të vlerësimit total lidhen me</i>

	<p>plotësimin e detyrimeve të vazhdueshme (laboratorë, detyra kursi, etj), ndërkohë 90% e pikëve lidhen me dy provime në lëndë: 40% të vlerësimit përfundimtar nga një provim i ndërmjetëm dhe 50% të vlerësimit përfundimtar nga provimi final.</p> <p>- <u>GVJ sugjeron</u> që në varësi të lëndës dhe në respektim të lirisë akademike, për më tepër për studime të nivelit master, të shikohet mundësia e fleksibilitetit në ndarjen e vlerësimit sipas formave të kontrollit të dijeve.</p> <p>- <u>GVJ sugjeron</u> të rishihen kreditet e vitit të II-të, të jenë 60 kredite ECTS me total 1500 orësh.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit është i hartuar me lëndë të cilat janë esenciale për marrjen e njohurive në fushën e bankës dhe financave. Emërtimi i programit të studimit tregon kompetencat që përfitojnë studentët që diplomohen në këtë program studimit. Emërtimi i lëndëve është në përshtatje me përmbajtjen e tyre dhe janë të njëjta me lëndë të ngjashme që zhvillohen në programe të tjera studimi të ngjashme nga fusha e studimit. Lëndët mundësojnë marrjen e njohurive të nevojshme për krijimin e një baze njohurish të plota për të avancuar më tej në studime të specializuara në financë dhe bankë. Lëndët si Analizë dhe Vlerësim biznesi, Tregjet dhe Institucionet financiare, Amvisimi i portofolit, Drejtim bankar i ndërmjetëm, Auditim bankar, etj ofrojnë njohuri të avancuara financiare dhe bankare të cilat janë të nevojshme për të formular ekspertë në fushën e bankës dhe financës.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p>

	<i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave Bankë-Financë zhvillohet në dy vite akademike dhe ka një ngarkesë totale kreditesh europiane prej 120 ECTS, sipas Planit mësimor të vitit 2021-2022. Çdo vit akademik ka 60 ECTS. Në Planin mësimor të vitit 2022-2023 Plani mësimor ka 115 ECTS.</p> <p>Një kredit ECTS zhvillohet në 25 orë mësimi dhe në total programi i studimit zhvillohet në $120 * 25 = 3.000$ orë mësimore.</p> <p>GVJ konstaton se lëndët që zhvillohen në përgjithësi janë lëndë që zhvillohen edhe në programe të tjera studimi të të njëjtës fushë. <i>GVJ konstaton gjithashtu se ka edhe lëndë të cilat nuk lidhen me drejtimin e studimit dhe nuk gjenden në Mastera të të njëjtit drejtim si: "Drejtim i Avancuar i Projekteve" dhe "Marketing i avancuar".</i></p> <p>Lëndët që zhvillohen në vitin e dytë dhe të tretë zhvillojnë dhe thellojnë njohuritë e bankave dhe financave të bankave, njohuri të nevojshme për tu punësuar në sektorin public dhe privat sin e kompani ashtu edhe në sistemin bankar.</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave Bankë Financë, neni 4, përcaktohet se programi i studimit synon formimin e profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën e bankës dhe financës. Njohuritë e marra për financat dhe bankat janë bashkëkohore dhe do ti bëjnë ata të aftë në përballjet me sfidat kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvillimeve ekonomike. Lëndet zhvillohen në kredite dhe orë mësimore që mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master</p>	<p>Struktura e programit, lëndët, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit. Programi i studimit ka në përbërje lëndë, të cilat gjenden në përbërje të programeve të ngjashme mësimore si kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Në këtë program studimi zhvillohet edhe Praktika profesionale duke ndihmuar studentët të jenë më pranë tregut. Programi i studimit është hartuar dhe shprehur në orë që zhvillohen në auditor, jashtë auditorit si dhe orët e praktikës profesionale. Në</p>

<p>Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>planin mësimor të vitit 2021-2022 në vitin e parë të studimit realizohen 69 ECTS, ndërsa në vitin e dytë zhvillohen 51 ECTS.</p> <p>Në vitin e parë realizohen 1725 orë në total nga të cilat 765 orë në auditor dhe 960 orë studim individual.</p> <p>Në vitin e dytë realizohen 399 orë në auditor dhe 876 orë studim i pavarur, me një total prej 1275 orë.</p> <p>Në auditor janë zhvilluar gjithsej në të dy vitet 1164 orë nga të cilat 700 orë janë zhvilluar në leksione, 350 orë janë zhvilluar në seminare dhe 90 ore për praktikën.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Leksione 510+ 190 = 700 orë ▪ Seminare 255+ 95 = 350 orë ▪ Praktikë profesionale 90 orë <p>Totali 1.140 orë</p> <p>Raporti Teori/ Praktikë, duke mos përfshirë mikrotezën është rreth 61,4%/38,6% (1.140 orë leksione/645 orë seminar dhe praktikë).</p> <p>Sipas dokumentacionit e depozituara nga institucioni, në lidhje me Riorganizimin, në riorganizimin e bërë në vitin 2021 është ndryshuar lënda Sistemet e Informacionit Kontabël në lëndën Kontabilitet i Aplikuar duke përfshirë një lëndë me njohuri mbi Kontabilitetin, duke mos ndikuar në lëndët e specialitetit Financë dhe Bankë. Ndërsa në Riorganizimin e vitit 2022-2023 është ndryshuar lënda Ekonomiks Manaxherial në lëndën Ekonometri, kjo e fundit e rëndësishme për kërkim shkencor të studentëve që studiojnë në Master shkencor.</p> <p><i>Në tabelat e depozituara nga institucioni në Planet mësimore ka mospërputhje të numrit të krediteve me kurrikulën e programit. (sqsuar në Standartin II.3, Kriteri 2)</i></p> <p>Ndërkohë në tabelën 9, ku jepen Veprimtaritë formuese, lëndët përputhen me vendimet e riorganizimit si në emërtime ashtu edhe në kredite.</p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 49.1_Riorganizim Master nën 20_, 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 49.2_Riorganizim Master nën 20_, 2021-2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe</p>	<p>Veprimtaritë formuese për programin e studimeve janë në përputhje me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e</p>

<p>raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.</p> <p>Në nenin 7, të Rregullores së programit të studimit jepet struktura e programit mësimor Master i Shkencave Bankë-Financë ku veprimtaritë formuese grupohen në:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Lëndë bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike, etj. b) Lëndë karakterizuese që lidhen me veçoritë e programit të studimit. c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë disiplina. d) Lëndë plotësuese, për aftësi si Praktika Profesionale. e) Detyrime përmbyllëse që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës. <p>Lëndët sipas veçorive të programit të studimit ndahen në: lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje. Ky program studimi ka lëndë me zgjedhje në të dy vitet.</p> <p>Lëndët apo modulet mundësojnë transferimet e studentëve. UAMD ofron mundësi për njohje kreditesh dhe transferim studimesh (<i>Rregullore e programit të studimit, neni 10</i>) sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e studimit dhe nenit 47 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit. Transferimet lejohen midis programeve të të njëjtit cikël studimi. Neni 15 i programit të studimeve si dhe neni 50 i Rregullores së Fakultetit të Biznesit rregullon shkëmbimet (mobilitetet) studentore, ku studentëve ju njihen provimet e dhëna jashtë shtetit për lëndët e njëjta apo të ngjashme.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i> <i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i> <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e</p>	<p>Syllabusi është programi i lëndës në të cilin parashikohen objektivat e përgjithshme të lëndës, literatura e detyrueshme dhe e sygjëruar, temat, orët e leksioneve dhe seminareve, kohëzgjatja e zhvillimit të lëndës, ngarkesa në kredite që ka lënda, mënyrat e vlerësimit, titullarin e lëndës, etj. (<i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit, neni 53</i>).</p>

<p>tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit dhe syllabuset kanë qenë objekt i përditësimit, veçanërisht gjatë riorganizimeve të këtij programi studimi. Gjatë vizitës në institucion GVJ ju komunikua nga stafi se përditësimi i syllabuseve dhe programit ka qenë në qendër të diskutimeve dhe ky program studimi është riorganizuar dy here. Si bazë për përditësimin e syllabuseve merret opinion i studentëve, mendimet e ekspertëve, vrojtimi i ndryshimeve më të fundit në fushat e bankë financës si në treg ashtu edhe në programe të ngjashme të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët dhe përmbajtja e tyre ofron njohuri për një specialist në fushat e financës dhe bankës.</p> <p>Kështu lëndët si Analizë dhe Vlerësim biznesi, Tregjet dhe Institucionet financiare kompletojnë njohuritë dhe kompetencat në financë. Lëndët si Drejtim bankar i ndërmjetëm, Auditim bankar, etj, ofrojnë njohuri në fushën bankare.</p> <p><i>Ajo që vihet re është përsëritja e lëndës Tregjet dhe institucionet financiare, e cila zhvillohet edhe në nivelin Bachelor. Në nivelin Bachelor Bankë-Financë zhvillohet lënda Menaxhim Risku, ndërkohë në Master shkencor Bankë-Financë zhvillohen edhe 2 lëndë Menaxhimi risku: Menaxhimi i Riskut të Ndërmjetëm dhe Menaxhimi i Riskut të kredisë. Masteri shkencor është në fushën e Financës dhe Bankës dhe lëndë për Menaxhimin e Riskut meqënëse zhvillohet në nivelin bachelor, mund të ishte vetëm një lëndë e këtij drejtimi në master.</i></p> <p><i>Lënda Drejtim Projekti zhvillohet në nivelin Bachelor duke bërë që lënda Drejtim i Avancuar Projekti të mos jetë shumë i rëndësishëm, si dhe jashtë fushës së studimit në Master shkencor Bankë-Financë.</i></p> <p>Programi i studimit ka shumë lëndë kontabilitetit për një master në fushën e financës dhe bankës. <u>Janë 5 lëndë kontabiliteti</u>, ku edhe pse disa me zgjedhje në planin mësimor të vitit 2021-2022 janë zhvilluar 4 lëndë kontabiliteti:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontabiliteti financiar i Ndërmjetëm; - Standartet Kombëtare të Kontabilitetit në Institucionet financiare;

	<ul style="list-style-type: none"> - Kontabiliteti i Insitucioneve financiare; - Kontabiliteti Manaxherial; <p><i>GVJ vlerëson se janë shumë lëndë të drejtimit të kontabilitetit për një program studimi në Bankë-Financë.</i></p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë ka në përbërje të tij lëndë të cilat gjenden në programe të ngjashme të të njëjtës fushë dhe cikël studimi. GVJ konstaton se lëndët janë bashkëkohore, të rëndësishme dhe përmbajtja e tyre mundëson kompletimin e studentëve me njohuri bazë dhe të thelluara në fushën e bankës dhe financës. Të diplomuarit kanë marrë njohuri të mjaftueshme në përfundim të këtij programi studimi për tju përgjigjur kërkesave të tregut për specialistë në fushat e bankës dhe financës. Megjithatë GVJ thekson mendimin që ka përsëritje të lëndëve të Bachelor dhe lëndë jo të nevojshme për fushën e studimit.</p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Lëndët e programit të studimit mundësojnë marrjen e njohurive të nevojshme për krijimin e një baze njohurish të plota për të avancuar më tej në studime të specializuara në financë dhe bankë.</i> - <i>GVJ konstaton se programi i studimit dhe syllabuset kanë qenë objekt i përditësimit, veçanërisht gjatë riorganizimeve të këtij programi studimi.</i> - <i>Lëndët si Analizë dhe Vlerësim biznesi, Tregjet dhe Institucionet financiare kompletojnë njohuritë dhe kompetencat në finance. Lëndët si Drejtimit bankar i ndërmjetëm, Auditim bankar, etj ofrojnë njohuri në fushën bankare.</i> <p><i>GVJ thekson mendimin që ka përsëritje të lëndëve të Bachelor dhe numër i lartë lëndësh të drejtimit të Kontabilitetit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

			X	
--	--	--	----------	--

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit institucioni tërheq opinionet dhe kërkesat e bizneseve nëpërmjet Panairit të punës. Institucioni nëpërmjet strukturave të tij, Departamenti, grupet kërkimore mësimore shkencore organizon punën për hartimin dhe sigurimin e cilësisë në programin Msc në Bankë-Financë, nëpërmjet diskutimeve në mbledhjet e realizuar, anketave, vëzhgimeve dhe kontrollove periodike. Departamenti analizon mundësinë për riorganizimin e programit mësimor duke u mbështetur në evidenca. Institucioni ka realizuar Analizën e tregut të punës për Msc në Bankë-Financë për të kuptuar nevojat e papërbushura të tregut për specialistë në këtë drejtim dhe mundësinë e kërkesave që do të ketë për këtë program prej tregut. Institucioni realizon edhe anketimin e ekspertëve në lidhje me kurrikulat me qëllim përditësimin e tyre. Institucioni analizon ecurinë e programit të studimit, nëpërmjet anketimit të studentëve.</p> <p><i>Evidencë 73_Pyetësor shpërndarë ekspertëve për përmirësimin e kurrikulave .pdf</i></p> <p><i>Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BsC MsC MP.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në</p>	<p>Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit. Me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit dhe mësimdhënies NJSBC zhvillon pyetësorin me studentët. Në nenin 6 përcaktohet mënyra e arritjes së sigurimit të cilësisë. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të</p>

<p>ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri. GVJ gjatë vizitës në institucion, u takua me studentë të këtij programi studimi dhe ata pohuan se bëhen pjesë e përmirësimit të programit të studimit nëpërmjet anketimeve dhe diskutimeve që zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme,</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti është njësia që organizon punën për hartimin dhe sigurimin e cilësisë në programin bachelor “Bankë-Financë”. Departamenti harton dhe miraton planin strategjik të zhvillimit të Departamentit. Departamenti ushtron çdo funksion tjetër për vlerësimin e programit të studimit, kurrikulat, kriteret e pranimit të studentëve, etj.</p> <p>Një nga prioritetet e Departamentit të Financë Kontabilitet, e shprehur në Strategjinë e Departamentit 2021-2025, është krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit, komunikimit dhe qasja ndërdisiplinore për bashkëpunim të ndërsjelltë me institucionet bankare dhe biznese të ndryshme në shërbim të ndërtimit të urave lidhëse midis universitetit dhe biznesit. Strategjia kryesore është përditësimi i kurrikulave në dakortësi me dekanatin e Fakultetit dhe në shërbim të njohurive të nevojshme për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm. Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit ka rëndësi si për përditësim të programit të synimit ashtu edhe për promovim të programit të studimit dhe punësim të studentëve të diplomuar.</p> <p><i>Evidencë 12_Plani Strategjik, Departamenti Financë - Kontabilitet, 2021-2025.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni nëpërmjet strukturave të tij, Departamenti, grupet kërkimore mësimore shkencore organizon punën për hartimin dhe sigurimin e cilësisë në programin Msc në Bankë-Financë, nëpërmjet diskutimeve në mbledhjet e realizuar, anketave, vëzhgimeve dhe kontrollove periodike.</i> - <i>Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit</i>

	<p>akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri.</p> <p>- Departamenti Financë Kontabilitet ka prioritet përmirësimin dhe përditësimin e kurrikulave në shërbim të njohurive të nevojshme për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Msc në Bankë- Financë përcaktohen misioni dhe objektivat formuese të programit të studimit. Programi synon formimin e studiuesve dhe profesionistëve të rinj në fushën e financës dhe bankës. Për arritjen e këtij objektivi ofrohet një bazë studimore teorike, kërkimore dhe profesionale. <i>(Rregullore e programit të studimit, neni 4).</i></p> <p>Programi ka si objektiv të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore në drejtimet bankë dhe financë, duke mundësuar njohuritë e nevojshme për tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Këto objektiva janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UAMD. UAMD ka për qëllim zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës dhe ekonomisë. Universiteti ka për qëllim të përgatisë specialistë që i përgjigjen kërkesave të tregut (Statuti i UAMD, neni 4).</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf, Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e</p>	<p>Drejtuesi i Departamentit kordinon veprimtarinë dhe drejton punën e njësisë duke u mbështetur në vendimet e njësisë</p>

<p>mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>(Rregullore e FB, neni 21). Ai është përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësisë dhe përmbushjen e detyrave.</p> <p>Drejtuesi i njësisë kryesore koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore, si dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre, drejton asamblenë e njësisë kryesore, etj. (Rregullore e FB, neni 18). Drejtuesi i njësisë kryesore mbikëqyr zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore në përputhje me planin e miratuar, si dhe ushtron kontrolle për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe projekteve. UAMD gëzon lirinë akademike (Statuti, neni 5). Liria akademike e personelit akademik garantohet nëpërmjet të drejtës për të organizuar veprimtari të mësimdhënies, kërkimore shkencore, veprimtaritë krijuese, etj. Liria akademike garantohet në hartimin dhe zhvillimin e programeve të studimit, etj.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf, Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Studentët njoftohen me anë të platformave online në lidhje me aktivitetet apo mundësitë e reja për ta. Studentët nxiten të aksesojnë bibliotekat online dhe të realizojnë kërkime shkencore dhe projekte kursi. Studentët nxiten të marrin pjesë në trajtime dhe leksione të hapura apo konkurse të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare që zhvillohen.</p> <p><i>Evidencë 28_Njoftime Aktivitete për studentet MSc BF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 37_Trajnime dhe mobilitete Erasmus +, PAE, v.a 2017-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 38_Pjesëmarrjet në programet Erasmus + për studentët, v.a 2017-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 44_Njoftim për Konkurse, projekte për studentët.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. Mbështetja financiare realizohet me anë të Autonomisë financiare (Statuti, neni 5). Me propozim të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit përcakton fondet e dedikuara për kërkim shkencor (Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore, neni 5).</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf</i></p>

	<i>Evidencë 54 Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore.pdf</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Programi ka si objektiv të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore në drejtimet banke dhe financë, duke mundësuar njohuritë e nevojshme për tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik t ëvendit. Këto objektiva janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UAMD. UAMD ka për qëllim zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës dhe ekonomisë.</i> - <i>Liria akademike e personelit akademik garantohet nëpërmjet të drejtës për të organizuar veprimtari të mësimdhënies, kërkimore shkencore, veprimtari të krijuese, etj. Liria akademike garantohet në hartimin dhe zhvillimin e programeve të studimit, etj.</i> - <i>Studentët nxiten të marrin pjesë në trajtime dhe leksione të hapura apo konkurse të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare që zhvillohen.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Njësia bazë, Departamenti në përputhje me numrin e personelit akademik, fushat kërkimore shkencore, disiplinat, etj, propozon grupet mësimore e kërkimore shkencore. <i>(Rregullore e e Departamentit të Financë Kontabilitetit, neni 14).</i></p> <p>Përgjegjësi i grupit mësimor e kërkimor shkencor organizon hartimin e kurrikulave të disiplinave që mbulon grupi dhe i paraqet në departament për diskutim. Bashkëpunimi me strukturat e tjera realizohet nga personeli akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe pune, komisione apo në realizimin e detyrave të caktuara akademike dhe administrative në nivel</p>

	<p>Njësia Bazë, Njësia Kryesore apo në nivel Institucioni (<i>Rregullore e e Departamentit të Financë Kontabilitetit, neni 16</i>).</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Në Planin Strategjik 2021-2025 të Fakultetit të Biznesit është pasqyruar angazhimi aktual dhe i ardhshëm i stafit akademik, për tu angazhuar që të jenë pjesëmarrës në konferenca ndërkombëtare, brenda dhe jashtë Shqipërisë (mesatarisht 2-3 konferenca në një vit akademik) si dhe në rreth 2- 3 botime në një vit akademik. Anëtarët e stafit akademik janë angazhuar edhe në trajnime të ndryshme Erasmus+ në vende të ndryshme të Europës dhe më gjërë. Rritja e produktit shkencor të stafit akademik si dhe promovimi dhe diskutimi i rezultateve të kërkimit shkencor në department duke organizuar tryeza të rumbullakëta, si dhe pjesëmarrje në ëorkshope, simpoziume, të organizuara nga Fakulteti si dhe konferenca të organizuara nga Fakulteti, UAMD dhe konferenca të tjera kombëtare e ndërkombëtare. Gjithashtu nxitet edhe përfshirja e studentëve në konferenca nën drejtimin e lektorëve të fushës.</p> <p><i>Evidencë 11_Plani Strategjik, Fakulteti i Biznesit, 2021-2025.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Njësitet kryesore dhe njësitet bazë bëjnë propozime për organizim të aktiviteteve kërkimore shkencore. Fakulteti i biznesit organizon çdo vit Konferencën Shkencore të Fakultetit dhe Konferencën Studentore. Konferencat ju vijnë në ndihmë stafit akademik për të realizuar punime dhe kërkime shkencore të nevojshme për avancimin e tyre në karrierë dhe për të pasuruar dhe përditësuar literaturën e lëndëve. Studentët realizojnë kërkime të cilat do të ndihmojnë në punimin e Mikrotezës dhe për të njohur tregun e punës.</p> <p><i>Evidencë 54_Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 202_Vendim Dekanati Konferenca studentore 2020.pdf</i> <i>Evidencë 201_Vendim për grupet e punës në Konferencën e FB, v.a 2021-2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit synon pajisjen e studentëve me njohuritë bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në fushën Financës dhe të Bankës.</p> <p>Qëllimi i programit të studimit realizohet me anë të lëndëve dhe moduleve përbërëse, analizës së tregut të punës dhe</p>

	<p>marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione të tjera publike dhe private. Me anë të mobiliteteve jashtë vendit mundësohet pajisja e studentëve me njohuri të nevojshme si për tregun vendas ashtu edhe për tregun ndërkombëtar.</p> <p><i>Evidencë 27_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Programi i studimit zhvillohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, dhe udhëzimet në fuqi. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale për të ndihmuar që studentët të pajisen me njohuri të nevojshme për çertifikime apo liçenca të nevojshme për tregun e punës. Ky program studimi është program bashkëkohor dhe formon profesionistë për të cilët ka nevojë tregu dhe në funksion të të cilit ka qenë dhe objekt riorganizimi. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione dhe organizma të ndryshme rrisin mundësinë për krijimin e kompetencave të nevojshme.</p> <p><i>Evidencë 27_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>N/A</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Qëllimi i programit të studimit realizohet me anë të lëndëve dhe moduleve përbërëse, analizës së tregut të punës dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione të tjera publike dhe private.</i> - <i>Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të institucionit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe pune, komisione apo në realizimin e detyrave të caktuara akademike dhe</i>

	<p><i>administrative në nivel Njësie Bazë, Njësie Kryesore apo në nivel Institucioni.</i></p> <p><i>- Fakulteti i biznesit organizon çdo vit Konferencën Shkencore të Fakultetit dhe Konferencë Studentore, që vijnë në ndihmë të stafit akademik për të realizuar punime dhe kërkime shkencore të nevojshme për avancimin e tyre në karrierë dhe për të pasuruar dhe përditësuar literaturën e lëndëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Forma e mësimdhënies në këtë program studimi është ndërthurje e formave të mësimdhënies si leksion, seminar, diskutime në auditor në ndërthurje të leksioneve dhe seminareve, detyrë kurs/ese, provim i ndërmjetëm dhe provim përfundimtar. Sipas kurrikulës Msc në Bankë- Financë realizohen çdo vit 1500 orë në auditor dhe jashtë auditorit me një total 3000 orë në dy vite.</p> <p><u>Në vitin e parë</u> realizohen 765 orë në auditor;</p> <p><u>Në vitin e dytë</u> realizohen 399 ore në auditor dhe 90 orë në auditor për praktikën profesionale;</p> <p>Në këtë program studentët ndjekin orët e hapura të organizuara nga institucioni, të zhvilluara nga ekspertë dhe pedagogë. Praktika profesionale zhvillohet nga student në fund të studimeve pasi kanë mbyllur pozitivisht të gjitha provimet.</p>

	<p>Praktika profesionale ka 12 ECTS me një total prej 300 orësh, ku 90 orë realizohen në auditor dhe 210 orë studim i pavarur.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 36_Leksionet e hapura dhe aktivitetet e Departamentit Financë Kontabilitet, v.a 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies për tju përgjigjur nevojave të studentëve dhe mësimdhënies në përgjithësi. Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të universitetit, këshillim të studentëve, etj, (<i>Rregullore e Departamentit të Financë-Kontabilitetit, neni 16</i>).</p> <p>Format e metodat e mësimdhënies ju bëhen të ditura studentëve me anë të syllabusve. Në syllabuse pasqyrohen larmia e metodologjisë së përdorur si leksionet me anë të të cilave studentët marrin njohuri teorike të cilat i vënë në praktikë apo krahasojnë praktikat në lidhje me to në orët e diskutimeve dhe detyrave të kursit. Personeli akademik përcakton orët e konsultimeve për studentët në mënyrë që të diskutojnë çështje apo probleme të paqarta.</p> <p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Për të kryer veprimtarinë e tyre në funksion të studentëve është shumë e rëndësishme teknologjia e informacionit dhe në Planin e Zhvillimit Strategjik 2020 – 2025 të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, përcaktohet se prioritet është ofrimi i shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ambjentet e institucionit pasi teknologjia e informacionit dhe komunikimit është themelore për kërkimin shkencor, praktikat mësimore dhe veprimtaritë e tjera të komunitetit universitar dhe shërbimi ndaj studentëve do të jetë më pranë nevojave. Me anë të workshop-eve dhe marrëveshjeve të lidhura dhe programit Erasmus+ institucioni krijon mundësinë për rritje profesionale, për mobilitete trajnimi dhe mësimdhënie të stafit akademik duke rritur kapacitetet pedagogjike dhe didaktike të stafit akademik.</p>

	<p>Evidencë 4_ Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025.pdf</p> <p>Evidencë 37_Trajnime dhe mobilitete Erasmus +, PAE, v.a 2017-2022.pdf</p>																																																														
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Me anë të formave të përdorura për shpjegimin e koncepteve dhe dhënien e njohurive si dhe me format e kontrollit të dijeve mundësohet një mësimdhënie interactive dhe nxitet të menduarit kritik tek studentët.</p> <p>Tabela vijuese jep të dhëna mbi kualifikimin e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie.</p> <table border="1" data-bbox="592 819 1385 1373"> <thead> <tr> <th colspan="7">Personeli akademik për programin e studimit Master i Shkencave në Bankë Financë</th> </tr> <tr> <th rowspan="2">Titulli/Grada</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc.</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>9</td> <td>1</td> <td>10</td> <td>1</td> <td>11</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr. në proces</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>3</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>13</td> <td>5</td> <td>13</td> <td>6</td> <td>15</td> <td>5</td> </tr> </tbody> </table> <p>Për vitin 2021-2022, 68,4% e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit është personel akademik efektiv dhe 84% e tyre janë me grada/ tituj akademik. Per vitin 2022-2023 personeli akademik eshte me i lartë, 75% e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit është personel akademik efektiv dhe 80% e tyre janë me grada/ tituj akademik.</p> <p>Zhvillimi i teknologjisë i ka sjellë më afër marrëdhënien pedagog student. Me ane metodave të mësimdhënies dhe të teknologjisë krijohet një marrëdhënie efektive dhe respekti ndërmjet pedagogëve dhe studentëve, gjë që u konfirmua edhe nga studentët gjatë vizitës në institucion.</p>	Personeli akademik për programin e studimit Master i Shkencave në Bankë Financë							Titulli/Grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	2	1	2	1	1	Prof.Asoc.	1	2	0	2	0	2	Dr	9	1	10	1	11	1	Dr. në proces	0	0	2	0	3	0	Msc	2	0	0	1	0	1	Gjithsej	13	5	13	6	15	5
Personeli akademik për programin e studimit Master i Shkencave në Bankë Financë																																																															
Titulli/Grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																																										
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																									
Prof.Dr	1	2	1	2	1	1																																																									
Prof.Asoc.	1	2	0	2	0	2																																																									
Dr	9	1	10	1	11	1																																																									
Dr. në proces	0	0	2	0	3	0																																																									
Msc	2	0	0	1	0	1																																																									
Gjithsej	13	5	13	6	15	5																																																									

	<p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 96.1_Të dhëna për programin e studimit MSc BF.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Personeli akademik harton programin mësimor të lëndës, ai duhet ta plotësojë dhe përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme dhe ta dorëzojë atë në Departament, ku kjo e fundit është përgjegjëse për programin e studimit. Departamenti vlerëson programin e studimit, ku në përbërje të tij janë format e metodat e mësimdhënies (<i>Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet, neni 17</i>). Departamenti i Financë-Kontabilitetit ka detyrimin që në çdo fillim viti akademik të përcaktojë ngarkesën mësimore dhe personelin e akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke marrë parasysh kualifikimet dhe eksperiencën në fushën përkatëse (<i>Rregullore e programit të studimit Msc në Bankë- Financë, neni 8</i>).</p> <p>Studentët janë aktivë në dhënien e opinionit të tyre jo vetëm nëpërmjet diskutimeve por edhe nëpërmjet anketave që plotësojnë studentët ku japin vlerësimin dhe mendimin e tyre mbi lëndët dhe format e metodat e mësimdhënies. Institucioni harton Raporte mbi ecurinë e veprimtarisë në uniuniversitet, fakultete dhe programe mësimore. Hartohet në mënyrë periodike Raport i analizës së ecurisë së studimit Msc në Bankë-Financë</p> <p><i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf, Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin</p>	<p>Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në rregulloren e Sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, neni 2, jepen strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senati Akademik; • Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC); • Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC); • Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL);

<p>dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC); <p>Strukturat përgjegjëse për cilësinë janë struktura që përcaktojnë politikën e cilësisë së institucionit, mbikëqyrëse, vlerësuese dhe garantuese të cilësisë (<i>Rregullore e UAMD, neni 20</i>).</p> <p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti) • Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.) • Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc. <p>Sigurimi i cilësisë shtrihet në të gjitha programet e studimit, pavarësisht ciklit të studimit. Institucioni ka ngritur njësi edhe në njësitë kryesore në mënyrë që kordinimi dhe bashkërendimi ndërmjet Institucionit dhe njësive kryesore dhe më tej njësive bazë të jetë rezultativ në lidhje me cilësinë. Institucioni me anë të bashkëpunimeve, trajnimeve dhe leksioneve të hapura ka si qëllim përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf, Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në këtë program studentët ndjekin orët e hapura të organizuara nga institucioni, të zhvilluara nga ekspertë dhe pedagogë. - Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të universitetit, këshillim të studentëve, etj - Me anë të workshop-eve dhe marrëveshjeve të lidhura dhe programit Erasmus+ institucioni krijon mundësinë për rritje profesionale, për mobilitete trajnimi dhe mësimdhënie të stafit akademik duke rritur kapacitetet pedagogjike dhe didaktike të stafit akademik. - Institucioni harton Raporte mbi ecurinë e veprimtarisë në universitet, fakultete dhe programe mësimore. Hartohet në




	<p><i>mënyrë periodike Raporti i analizës së ecurisë së studimit Msc në Bankë- Financë.</i></p> <p>- <i>Sigurimi i cilësisë shtrihet në të gjitha programet e studimit, pavarësisht ciklit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Forma e kontrollit të dijes në këtë program studimi është me anë të provimit me shkrim. (10%) e vlerëimit gjithsej i përket vlerësimit të detyrave të kursit, projekteve individuale dhe eseve ndërsa (90%) dhe me anë të provimeve me shkrim (<i>Rregullore e programit të studimit Msc në Bankë- Financë, neni 14</i>).</p> <p>Për kontrollin e dijeve zhvillohen 2 provime me shkrim. Provimi i parë i quajtur i ndërmjetëm zhvillohet në javët e 7 ose 8 dhe përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar (<i>Rregullore e UAMD, neni 68</i>).</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit nga neni 59 deri në nenin 70 jepen rregullat dhe procedurat që ndiqen për kontrollin e dijes, rregullat e zhvillimit të provimeve, riprovimeve deri tez mbrojtja e Tezës së diplomës. Provimi përfundimtar zhvillohet në javën e 15 ose 16 dhe përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit. Kjo mënyrë kontrolli e dijeve është e unifikuar në UAMD, dhe gjendet e shprehur edhe në Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf, Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sikurse u shprehëm në Kriterin 1, forma e kontrollit të dijës është ndërthurje e provimit të ndërmjetëm me shkrim (40% e vlerësimit), provimit përfundimtar (50% e vlerësimit) dhe detyrave, projekteve dhe/ose ese (10% e vlerësimit).</p> <p>Ky informacion jepet në Rregulloren e programit të studimit Bsc Bankë- Financë, në Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, dhe Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, të cilat janë publike. Metodologjia e vlerësimit të dijeve të lëndëve ju bëhet me dije studentëve në fillim të semestrit, në orën e parë të leksionit (<i>Rregullore e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, neni 62</i>).</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Zhvillimi i dy provimeve, mundëson që studenti të zhvillojë përgatitje individuale të vazhdueshme dhe sistematike. Provimi i ndërmjetëm zhvillohet në javën e 7 ose të 8 sipas skedulit të paracaktuar. Marrja e rezultateve të provimit në javën vijuese i jep mundësi studentëve të njohin mangësitë që kanë dhe kjo shërben si një mundësi për të njohur formën e vlerësimit final dhe si nxitje për rritje të aftësive didaktike dhe profesionale. Nëpërmjet copëzimit të vlerësimit në 3 pjesë, krijohet mundësia e vlerësimit më të saktë të njohurive dhe kopetencave të studentit.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <p><i>Për kontrollin e dijeve zhvillohen 2 provime me shkrim. Provimi i parë i quajtur i ndërmjetëm zhvillohet në javët e 7 ose 8 dhe përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit. Provimi përfundimtar zhvillohet në javën e 15 ose 16 dhe përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit.</i></p>

	<p><i>forma e kontrollit të dijës është një ndërthurje e provimit të ndërmjetëm me shkrim, provimit përfundimtar dhe detyrave, projekteve dhe/ose ese.</i></p> <p><i>Nëpërmjet copëzimit të vlerësimit në 3 pjesë, krijohet mundësia e vlerësimit më të saktë të njohurive dhe kopetencave të studentit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. Sikurse përcaktohet në Regulloren e institucionit, të njësinë kryesore dhe asaj bazë, testimi i njohurive bëhet me provim me shkrim dhe me detyra, projekte/ese, raste studimore, etj. Provimi me shkrim ndahet në dy provime, në provimin e ndërmjetëm që përbën 40% të vlerësimit dhe provimin përfundimtar që përbën 50% të vlerësimit. 10% e vlerësimit realizohet me anë të detyrave, projekteve/ eseve të cilat zhvillohen përgjatë gjithë semestrit kur zhvillohet lënda. Totali i të tre vlerësimeve, të cilat janë me pikë konvertohet në notë.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu”, për zhvillimin e provimeve përdor platformën Clean Score, e cila mundëson vlerësim elektronik të testimit. Kjo platformë përdoret nga institucioni që prej vitit akademik 2017-2018. Kjo platformë mundëson transparencën në provime si dhe shpejtësi në nxjerrjen e rezultateve të provimeve.</p>

	<p>Përveç platformes Clean Score stafi akademik operon edhe nëpërmjet sistemit Microsoft Teams që prej pandemisë, duke rritur mundësinë e metodave alternative të vlerësimit si dhe të transparencës dhe lehtësimit të komunikimit me studentët.</p> <p><i>Evidencë 170_Trajnim për Clean Score 2018-2019.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi, të jetësuar në rregulloret e institucionit dhe njësive kryesore dhe bazë. Mënyra e vlerësimit përfundimtar përcaktohet në Rregulloren e programit të studimit Msc Bankë- Financë, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Vlerësimi përfundimtar bëhet pasi mbliidhen pikët e fituara gjatë vitit të detyrave të kursit, projekteve / eseve, pikët e fituara në provimin e ndërmjetëm dhe pikët e fituara në provimin përfundimtar.</p> <p>Format e kontrollit të dijes janë të përcaktuara në syllabusin e çdo lënde, ku jepet informacion i detajuar për mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Studenti merr vlerësimin dhe komentet shoqëroese sipas rastit. Në rastin e detyrave të kursit dhe detyrave të tjera pedagogët japin vlerësimin e tyre dhe sygjërimet e tyre për përmirësim. Në rastin e provimit të ndërmjetëm, pedagogët japin rezultatin në javën vijuese dhe komentojnë në lidhje me rezultatin duke dhënë këshilla për tu përmirësuar në provimin final.</p> <p>Sipas rregulloreve të institucionit në rastin e provimit final studentin merr vlerësimin jo më shumë se 72 orë pas zhvillimit të provimit. Studenti ka të drejtë të ballafaqohet me pedagogun me fletoren e provimit dhe pedagogu përveç sqarimeve dhe shpjegimeve japin edhe këshilla në lidhje me mënyrën e zhvillimit të provimit në të ardhmen. Në rast të notës jokaluese këshillat dhe sygjërimet kanë rëndësi për sezonin vijues kur</p>

	<p>studenti do të zhvillojë sërish provimin dhe të rezultojë me vlerësim sa më të lartë.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Për të shmangur plagjiaturën, kopjimin në provime, etj institucioni është shprehur qartë në rregulloret e tij. Në Rregulloren e provimeve të Fakultetit të Biznesit, neni 4, janë përcaktuar rregullat e provimeve si: studenti duhet të paraqesë dokument identifikimi si kartë studenti, kartë identiteti, pasaportë apo patentë. Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës. Në provim nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi. Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës.</p> <p>Në Rregulloren e UAMD, neni 86, përcakton shkeljet disiplinore dhe llojin e masave disiplinore. Ndër shkeljet disiplinore përfshihen kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave, etj. Në vijim rregullorja e institucionit përcakton edhe llojet e masave disiplinore në rast të shkeljeve disiplinore.</p> <p><i>Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit.pdf, Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Koha e dhënies së rezultateve të kontrollit është e përcaktuar në Rregulloret përkatëse. Sipas rregulloreve të institucionit në rastin e provimit final studenti merr vlerësimin jo më shumë se 72 orë pas zhvillimit të provimit. Studenti ka të drejtë të ballafaqohet me pedagogun me fletoren e provimit dhe pedagogu përveç sqarimeve dhe shpjegimeve japin edhe këshilla në lidhje me mënyrën e zhvillimit të provimit në të ardhmen.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në</p>	<p>Rregulloret e institucionit shprehen në lidhje me zhvillimin e provimeve dhe marrjen e rezultateve nga ana e studentëve. Gjatë vizitës GVJ diskutoi me pedagogët dhe studentët në lidhje me marrjen në kohë të rezultateve dhe u konfirmua nga të dy palët se afatet kohore të marrjes së rezultateve ishin të shkurtra</p>




<p>përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>dhe çdo herë në kohën e paracaktuar. Në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, dhe Rregulloren e provimeve të fakultetit të Biznesit përcaktohen hapat e zhvillimit të provimeve. Provimet zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin e miratuar të vitit akademik. Për çdo seksion personeli akademik duhet të përgatisë të paktën 4 teza të ndryshme provimi. Teza duhet të përmbajë domosdoshmërisht pikët sipas vlerësimit të grup-pyetjeve, si dhe pikët totale, të vendosura në pozicion të dukshëm brenda tezës.</p> <p>Datat e provimeve përcaktohen dhe bëhen publike nga Fakulteti të paktën një javë përpara zhvillimit të tyre duke bërë shpërndarjen e provimeve në dy javë (javën e shtatë dhe të tetë, dhe javën e pesëmbëdhjetë dhe të gjashtëmbëdhjetë).</p> <p>Në rastin e provimit të ndërmjetëm rezultatet ju komunikohen studentëve në orën pasardhëse të mësimit, nga ana e personelit akademik duke bërë edhe ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Në rastin e provimit përfundimtar personeli akademik i lëndës cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur prej personelit akademik duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Përgjatë vitit studentëve u ofrohen tre sezone riprovimesh.</p> <p><i>Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit.pdf Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>E drejta e ankimimit është e përcaktuar në rregulloret e institucionit. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë studentin jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Përgjegjësi i Departamentit përcakton ditën dhe orën se kur do mbledhet komisioni ad hoc jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës dhe njofton për këtë orar personelin akademik të seksionit dhe studentin. 6. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik dhe nëse ka ndryshim në vlerësim bëhet reflektim në procesverbal.</p> <p><i>Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>

Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Format e kontrollit të dijes janë të përcaktuara në syllabusin e çdo lënde, ku jepet informacion i detajuar për mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm.</i> - <i>Koha e dhënies së rezultateve të kontrollit është e përcaktuar në Rregulloret përkatëse si për provimin e ndërmjetëm ashtu edhe provimin përfundimtar. E drejta e ankimit është e përcaktuar në rregulloret e institucionit.</i> - <i>Në Rregulloren e UAMD, përcaktohen shkeljet disiplinore dhe llojin e masave disiplinore.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Programi i studimit Msc në Bankë-Financë garanton thellimin e njohurive me anë të lënëve të fushës së financës dhe bankës të cilat mundësojnë pajisjen e studentit me informacione dhe njohuri bazë dhe të avancuara në këtë fushë që garantojnë zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve. Programi i studimit ka në përbërje lëndë të cilat gjenden në programe të ngjashme dhe mundësojnë formimin me kompetenca në bankë dhe financë për një të diplomuar në këtë pogram studimi. Gjatë vizitës në institucion GVJ ju komunikua se përditësimi i lëndëve duke synuar thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale ishte prioritet në këtë program studimi, i cili është riorganizuar dy herë që nga hapja e tij. Një rëndësi të veçantë në këtë drejtim ka edhe metodologjia e përdorur në zhvillimin e mësimit dhe format e vlerësimit të cilat vlerësohen si eficientë edhe nga studentët.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i> <i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit është i ndërtuar me module (lëndë) të cilat kanë si qëllim të formojnë studiues dhe kërkues të fushës së financës dhe bankës.</p> <p>Në programin e studimit Msc në Bankë- Financë janë përfshirë edhe syllabuset e lëndëve të cilat zhvillojnë aftësi të veçanta, të nevojshme dhe të rëndësishme për të krijuar një formim bashkëkohor të rëndësishëm si kërkues si Ekonometri, apo lëndë të rëndësishme ndërvepruese si E drejta bankare dhe e sigurimeve. Me anë të këtyre moduleve studenti njeh mënyrën e funksionimit të shërbimeve të cilat do të jenë të rëndësishme gjatë proceseve të punës, apo edhe realizimit të kërkimit shkencor gjatë dhe pas diplomimit në këtë program studimi.</p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve paraqesin përshkrimin e temave dhe lëndëve, numrin e krediteve, etj, dhe me rëndësi të veçantë është përshkrimi i objektivave të lëndës.</p> <p>Çdo lëndë ka objektivat e saj në lidhje me kompetencat që duhet të arrijnë studentët në fund të lëndës së zhvilluar dhe është në lirinë akademike të pedagogëve të zgjedhin metodologjinë dhe format më të mira të arritjes së tyre. Për këtë arsye syllabuset analizohen dhe shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme në funksion të rezultateve sa më të mira të studentëve e konkulluar kjo në rezultatin e provimeve, punësimin e studentëve dhe opinionin e vet studentëve në fund të përfundimit të lëndës. Pedagogët në orën e parë të leksionit njohin studentët me syllabusin e lëndës, me objektivat, temat, të drejtat dhe detyrimet, format e vlerësimit, etj, si dhe orientojnë studentët me anë të konsultimeve drejt çështjeve më të rëndësishme si në zhvillimin e provimit të lëndës, ashtu edhe në detyrimet përmbyllëse. Rregullorja e Diplomimit përcakton kushtet dhe procedurat për mbrojtjen e Tezës së Diplomës.</p> <p><i>Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 82_Rregullore Diplomimi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra</p>	<p>Mesimdhënia e realizuar në këtë program studimi bazohet në kompetenca në mënyrë që studentët të përdorin dhe zhvillojnë njohuritë e marra nëpërmjet aplikimit të tyre duke përdorur laboratorët dhe aplikimit gjatë praktikës profesionale.</p>

<p>në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Pedagogët nxisin dhe mbështesin diskutimet dhe punën në grup gjatë trajtimit të rasteve studimore, eseve dhe përgatitjen e detyrave të kursit. Nëpërmjet bashkëpunimeve institucionale mundësohen praktikat profesionale për një përshtatje sa më të shpejt me tregunë punës dhe për të siguruar njohuri plotësuese për të rritur kompetencat. Pedagogët që zhvillojnë mësimin në këtë program studimi janë kryesisht me grada dhe tituj, janë ekspertë të fushës financë bankë apo të drejtimeve të tjera për të cilat zhvillojnë lëndët. Pedagogët zhvillojnë lëndët me kompetencë, diskutojnë tematika dhe çështje bashkëkohore si dhe nxisin mendimin kritik dhe inovator.</p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 108_Syllabuse_sem 2_v.a. 2021-2022.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi çështje të rëndësishme bashkëkohore të fushës së studimit. Leksionet e hapura në lidhje me zhvillimet më të fundit të shkencës ekonomike janë përfituese si nga studentët edhe nga vet stafi akademik, në veçanti nga stafi akademik në proces doktorature. Departamenti i Financë-Kontabilitetit dhe pedagogë të departamenteve të tjera, si dhe ekspertë të fushës kanë zhvilluar disa leksione të hapura dhe workshop-e me tema bashkëkohore të Bankës dhe Financës.</p> <p><i>Evidencë 55_Aktivite Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Studentët nxiten të zhvillojnë kërkimin shkencor në kuadër të zhvillimit të mikrotezës dhe detyrave të kursit/ projekteve. Studentët nxiten të marrin pjesë në Konferencën studentore dhe Konferencën shkencore të institucionit, të marrin pjesë në ëorkshope, etj.</p> <p><i>Evidencë 55_Aktivite Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 64_Konferenca Studentore XII.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit Msc Bankë-Financë garanton thellimin e njohurive me anë të lënëve të fushës së financës dhe bankës të cilat mundësojnë pajisjen e studentit me informacione dhe

	<p><i>njohuri bazë dhe të avancuara në këtë fushë që garantojnë zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Në programin e studimit Msc në Bankë- Finacë janë përfshirë edhe syllabuset e lëndëve të cilat zhvillojnë aftësi të veçanta, të nevojshme dhe të rëndësishme për të krijuar një formim bashkëkohor.</i> - <i>Pedagogët nxisin dhe mbështesin diskutimet dhe punën në grup gjatë trajtimit të rasteve studimore, ese-ve, përgatitjen e detyrave të kursit dhe orëve të hapura.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu” ka hartuar rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Neni 3 i Rregullores së detyrimeve përmbyllëse (Tezës së diplomës) përcakton se studenti duhet të plotësojë të gjitha kushtet dhe të marrë të gjitha kreditet e nevojshme për të mbrojtur Tezën e diplomës. Rregullorja e Diplomimit përcakton kushtet dhe procedurat për mbrojtjen e Tezës së Diplomës.</p> <p><i>Evidencë 83 _Rregullore per praktikat mesimore.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 82 _Rregullore Diplomimi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Për zhvillimin e temës së diplomës studentët udhëhiqen nga pedagogët të cilët ndihmojnë me ide dhe materiale. Pedagogët udhëheqës janë me grada/tituj akademik.</p> <p>Studentët orientohen se si të ndërtojnë temën e diplomës. Në Rregulloren e Diplomimit, neni 13, përcaktohet struktura që duhet të ndiqet për hartimin e Tezës së Diplomës. Në përfundim të temës së diplomës merret aprovimi nga udhëheqësi i punimit për të mbrojtur temën në juri. Të gjitha rregulloret e</p>

	<p>institucionit, lista e temave të diplomës, njoftimet në lidhje me workshop-e dhe orë të hapura ku studentët do të ndihmohen në orientimin e kërkimit shkencor bëhen publike.</p> <p><i>Evidencë 82 _Rregullore Diplomimi.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14 _Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Bankë -Financë si detyrime përmbyllës ka Praktikë Profesionale dhe Tezë diplome (Mikrotezë). Ky program studimi nuk ka të përfshirë provim final.</p> <p><i>Evidencë 14 _Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 82 _Rregullore Diplomimi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studenti i cili ka shlyer të gjitha detyrimet bënë kërkesë pranë sekretarisë për mbrojtje të Tezës së Diplomës.</p> <p>Departamenti publikon një listë temash diplome për orientim. Studentët gjatë punës për Tezën e diplomës udhëhiqen nga pedagogë me grada dhe tituj akademik. Udhëheqësit i asistojnë si në përcaktimin e strukturës së tezës, ashtu edhe në shkrimin dhe nxjerrjen e rezultateve. Vlerësimi i Tezës së diplomës bëhet nga komisioni i ngritur, juria me së paku 3 anëtarë.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni asiston studentët në çdo stad të studimeve me anë të vënies në dispozicion si të procesit mësimor ashtu dhe të zhvillimit të Tezës së të diplomave (mikrotezave) laboratorët. Studentët shfrytëzojnë internetin për të marrë informacione të nevojshme në Bibliotekën online dhe më gjerë. Në kompjutera janë të instaluar software që nevojiten për fusha të caktuara që trajtohen në punime. Institucioni i ndihmon studentët me anë të marrëveshjeve që ka lidhur me institucione publike dhe private,</p>

	<p>duke lehtësuar marrjen e informacioneve dhe të të dhënave nga ana e studentëve.</p> <p><i>Evidencë 33_Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel institucioni.pdf Evidencë 42_Informacion për Bibliotekën Online.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Studenti që kalon me sukses tezën e diplomës/provimin e përgjithshëm përfundimtar pajiset me diplomën përkatëse.</p> <p>Punimi të lidhet në formë libri me kapak (kopertinë) kartoni. Në rregulloren e Tezës së diplomës përcaktohet edhe mënyra e vlerësimit, ku vlerësimi strukturohet në disa elementë të rëndësishëm si strukturimi i Tezës, prezantimi, formulimi i pyetjeve kërkimore etj, dhe në përfundim vlerësimi bëhet me notë.</p> <p><i>Evidencë 82 _Rregullore Diplomimi.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, kur studentit vlerësohet pozitivisht në tezën e diplomës, ai pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës. Në përfundim të programit të studimit studentit pajiset me diplomën: Diplomë e ciklit të dytë “Master i Shkencave në Bankë- Financë”.</p> <p>Së bashku me diplomën studentit merr listën e notave dhe suplementin e diplomës. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf, Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Detyrat e realizuar nga sekretaria përgjegjëse në ciklin e dytë, Master: Mbajtja, ruajtja, sistemimi dhe administrimi i dokumentacionit të çdo studentit të regjistruar pranë këtij Fakulteti në ciklin e dytë.</p> <p>Hedhja e të dhënave të studentëve të regjistruar për herë të parë në ciklin e dytë të studimeve Master në databazën elektronike. Gjeneralitetet e të gjithë studentëve për çdo vit akademik pasqyrohen nga sekretaret mësimore sipas udhëzimeve përkatëse, në regjistrat e tërhequr nga Institucioni përgjegjës</p>

	<p>për matrikullimin e studentëve. Te dhënat dhe informacionet ruhen në formë elektronike dhe fizike. Ruhen në formë fizike të arkivuar përgjithmonë Rregjistri themeltar për studentët e rregjistruar, procesverbalet e provimeve të ndërmjetëm dhe përfundimtar. Ruhen për periudha të përcaktuara tezat e provimeve, rregjistrat mësimor, dosjet e studentëve, etj.</p> <p><i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarise Mesimore ne FB.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Rregullorja e Diplomimit përcakton kushtet dhe procedurat për mbrojtjen e Tezës së Diplomës. Ne përfundim të programit të studimit studenti pajiset me diplomën: Diplomë e cikit të dytë "Master i Shkencave në Bankë-Financë".</i> - <i>Të gjitha rregulloret e institucionit, lista e temave të diplomës, njoftimet në lidhje me workshop-e dhe orë të hapura ku studentët do të ndihmohen në orientimin e kërkimit shkencor bëhen publike.</i> - <i>Udhëheqësit i asistojnë si në përcaktimin e strukturës së tezës, ashtu edhe në shkrimin dhe nxjerrjen e rezultateve.</i> - <i>Institucioni i ndihmon studentët me anë të marrëveshjeve që ka lidhur me institucione publike dhe private, duke lehtësuar marrjen e informacioneve dhe të të dhënave nga ana e studentëve.</i> 			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme	Programi i studimit Msc në Bankë – Financë ofrohet nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit të Fakultetit të Biznesit, UAMD. Fakulteti i Biznesit është fakulteti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit. Fakulteti i Biznesit ka në mjediset e saj laboratorë për zhvillimin e lëndëve të cilat e kanë të nevojshme aplikimin, si dhe për zhvillimin e Tezave të

<p>për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Diplomës si për shkrimin e tyre edhe për aksesimin e Bibliotekës online. Praktikrat profesionale zhvillohen pranë institucioneve dhe ndërmarrjeve me të cilat UAMD ka lidhur marrëveshje ndërkohë që për shkrimin e raportit përfundimtar mund të përdoren ambientet laboratorike të institucionit.</p> <p><i>Evidencë 83_Rregullore per praktikrat mesimore.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 87_Lista e laboratoreve dhe Kendi i studenteve.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Institucioni me anë të marrëveshjeve me partnerët publikë dhe privatë mundëson zhvillimin e praktikave profesionale. Zhvillimi i praktikave profesionale pranë bizneseve dhe institucioneve të tjera ju jep mundësi studentëve të njohin nga afër praktikën dhe mënyrën e aplikimit të njohurive të marra. Zhvillimi i praktikave profesionale është edhe një mundësi shumë e mirë për të njohur tregun e punës dhe për tu punësuar.</p> <p><i>Evidencë 33_Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel institucioni.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Në Rregulloren për praktikrat mësimore është e përcaktuar e gjithë praktika e zhvillimit. Studentët ndihmohen nga institucioni nëpërmjet marrëveshjeve me të tretë, ndërkohë që studentët mund ta gjejnë edhe vet vendin se ku do të zhvillojnë praktikën. Pas përfundimit 3 mujor të zhvillimit të praktikës, studentët dorëzojnë Raportin përfundimtar të praktikës sipas formatit të përcaktuar. Praktika profesionale mbrohet përpara një Komisioni vlerësimi, dhe vlerësohet me notë. Praktika Profesionale ka 12 ECTS dhe vlerësohet me notë.</p> <p><i>Evidencë 83_Rregullore per praktikrat mesimore.pdf</i></p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Fakulteti i Biznesit asiston studentët me mjediset e saj laboratorë për zhvillimin e lëndëve të cilat e kanë të nevojshme aplikimin, si dhe për zhvillimin e Tezave të Diplomës si për shkrimin e tyre edhe për aksesimin e Bibliotekës online.</i> - <i>Studentët ndihmohen nga institucioni nëpërmjet marrëveshjeve me të tretë, ndërkohë që studentët mund ta gjejnë edhe vet vendin se ku do të zhvillojnë praktikën. Pas përfundimit 3 mujor të zhvillimit të praktikës, studentët</i>




	<i>dorëzojnë Raportin përfundimtar të praktikës sipas formatit të përcaktuar, e mbrojnë përpara një komisioni dhe Praktika profesionale vlerësohet me notë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në raportin e vetëvlerësimit (RVB), dokumentacionin shoqërues të RVB-së, si dhe informacionin e marrë në takimet e realizuara gjatë vizitës në Universitetin e Durrësit (UAMD), GVJ konstaton se institucioni mban të dhëna të plota mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UAMD.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë ofrohet nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit, i cili ofron edhe tre programe master- dy programe master me drejtim shkencor (MSH Financë-Kontabilitet, MSH në Industria e Sigurimeve dhe Drejtimi i Riskut) dhe një program master me drejtim profesional (Master Profesional në Financë), si dhe dy programe bachelor Bsc. Bankë Financë dhe Bsc. Financë Kontabilitet.</p>

	<p>Në këtë program studimi, referuar Tabelës përmbledhëse-Tabela 6.1; 6.2; 6.3, të dhënat për stafin e angazhuar për mësimdhënie gjatë tre viteve akademike paraqiten si vijon:</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar 18 personel akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 12 PAE, nga të cilët 1 me titullin “Profesor i Asocuar”, 9 me gradën “Doktor” dhe 2 me Msc; • 6 PAK, nga të cilët 3 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asocuar” dhe 1 me gradën “Doktor”. <p>Ky program studimi për këtë vit akademik është mbuluar në nivelin 66.7% nga PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar 19 personel akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 13 PAE, nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 10 me gradën “Doktor” dhe 2 me Msc; • 6 PAK, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asocuar”, 1 me gradën “Doktor” dhe 1 me Msc. <p>Ky program studimi për këtë vit akademik është mbuluar në nivelin 68.4% nga PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2022-2023 janë të angazhuar 20 personel akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 15 PAE, nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 11 me gradën “Doktor” dhe 3 me Msc; • 5 PAK, nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asocuar”, 1 me gradën “Doktor” dhe 1 me Msc. <p>Ky program studimi për këtë vit akademik është mbuluar në nivelin 75% nga PAE.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi përgjithësisht përmbush kërkesat ligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë, nr. 80, 2015, neni 59) për nivelin e kualifikimit (PAE dhe PAK që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi) në lidhje me gradat shkencore. Ligji kërkon që duhet që ky personel akademik të ketë të paktën gradën Doktor, në një kohë që në këtë program studimi janë angazhuar personel</p>
--	---

	<p>akademik me Msc, megjithatë aktualisht janë në proces për përfundimin e Doktoraturës (përkatësisht 2 PAE për vitin akademik 2020-2021; 2 PAE dhe 1 PAK për vitin akademik 2021-2022, dhe 3 PAE dhe 1 PAK për vitin akademik 2022-2023).</p> <p>Ndërkohë personeli akademik i angazuar në këtë program studimi ka fushë kërkimore në përputhje me natyrën dhe veçoritë e lëndëve të ofruara. Fakulteti i Biznesit, si njësi kryesore, ka të angazhuar një personel ndihmës akademik prej 12 anëtarësh- sekretare dekani, sekretare departamentesh, sekretare mësimore dhe laborantë IT. Ky staf ndihmon në përmbushjen e aktivitetit mësimor dhe kërkimor të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, që ofrojnë këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Dokumenta shtesë_Tabela Ascal_MSC BF.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 1_Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015.pdf.pdf</i></p>																				
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik efektiv në këtë program studimi është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, duke plotësuar kushtet e kërkuara nga Ligji i Arsimit të Lartë për të dhënë mësim në Institucionet e Arsimit të Lartë, me përjashtim të angazhimit të personelit akademik me Msc të angazhuar në këtë program studimi, sic është përshkruar në kriterin e mësipërm. Kurrikula e këtij programi mbulohet kryesisht me personel akademik efektiv. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të marrë gjatë vizitës në institucion (<i>Dokumenta shtesë_Tabela Ascal_MSC BF.pdf.pdf, tab nr. 12.1</i>), u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për tre vite akademike është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="598 1547 1369 1821"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>1050</td> <td>780</td> <td>270</td> <td>74% / 26 %</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>1050</td> <td>657</td> <td>393</td> <td>63% / 37%</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>1005</td> <td>702</td> <td>303</td> <td>70% / 30%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Dokumenta shtesë_Tabela Ascal_MSC BF.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 1_Ligji i Arsimit të lartë Nr. 80, 2015.pdf.pdf</i></p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2020-2021	1050	780	270	74% / 26 %	2021-2022	1050	657	393	63% / 37%	2022-2023	1005	702	303	70% / 30%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2020-2021	1050	780	270	74% / 26 %																	
2021-2022	1050	657	393	63% / 37%																	
2022-2023	1005	702	303	70% / 30%																	




	<p><i>Evidenca 17_CV-të e lektorëve PAE, Programi Master i Shkencave Banke - Financë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 17.1_CV-të e lektorëve PAK, Programi Master i Shkencave Bankë - Financë.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit Master Shkencor në Bankë-Financë i ofruar nga Departamenti i Financë- Kontabilitetit. Kontratat e punësimit pranë UAMD dhe mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. PAE dhe PAK i angazhuar në këtë program studimi pothuaj nuk ka ndryshuar. Mbi 90% e stafit akademik është i angazhuar gjatë të dy viteve akademik.</p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit, faqen web të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ konstaton se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UAMD, që bazohet në këtë kuadër ligjor. Në statutin e UAMD janë të përcaktuara kriteret dhe procedurat që ndiqen në rekrutimin e personelit akademik (neni 45-47), si dhe ndihmës akademik (neni 52).</p> <p>Rekrutimi i personelit, bëhet me konkurrim të hapur. UAMD shpall konkursin për vend të lirë pune, pas kërkesës së Departamentit të Financë-Kontabilitetit, bazuar në nevojat e këtij të fundit. Njësia bazë përcakton kriteret specifike në lidhje me nivelin e duhur të kualifikimit në përputhje me modulet ku planifikohet të angazhohet kandidati për vendin e lirë të punës, të cilat miratohen nga rektori. Universiteti shpall konkursin për vende të lira pune, duke e publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike në formë të shkruar dhe elektronike. Kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit të personelit publikohen edhe në faqen zyrtare web të UAMD. Për realizimin e procesit të rekrutimit ngrihet një komision ad-hoc pranë njësisë bazë, i përbërë nga 5 anëtarë, nga të cilët jo më pak se tre janë përfaqësues të njësisë bazë. Ky proces realizohet në dy faza: faza e parë përfshin vlerësimin e dosjes së aplikantit dhe faza e</p>

	<p>dytë intervistën. Fazës së dytë i nënshtrohen vetëm kandidatët që janë kualifikuar në fazën e parë. Vlerësimi i kandidatit bëhet më pikë, sipas një strukture të përcaktuar në Procedurat e Rekrutimit të personelit- ku dosja e kandidatit vlerësohet me maksimumi 70% e totalit të pikëve, ndërsa intervista vlerësohet me maksimumi 30% e totalit të pikëve. Komisioni bën vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve. Drejtuesi i njësisë kryesore i paraqet rektorit listën e kandidatëve të renditur sipas vendimit të komisionit ad-hoc. Kontrata e punësimit lidhet nga rektori i UAMD. Në përfundim të procesit njoftohen për rezultatin e konkurrimit si aplikanti/aplikantët fitues, ashtu edhe ata jofitues.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 180_Rregullore Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Juridike.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 114_Procedura dhe formularët e përdorur për rekrutimin e personelit në UAMD.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 194_Kriteret për Rekrutimi i stafit me kohë të plotë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 186_Njoftim për staf akademik me kohë të pjesshme FB.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 183_Kritere dhe vende vakante stafi i ri_nder vite.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 119_Relacion mbi rekrutimin e lektoreve.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 116_Model Kontrate Pune - UAMD.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 124_Vertetim per kontributet e sigurimit shoqeror dhe shendetesor.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, dokumentacionin shoqërues si dhe vizitën në Institucion, konstaton angazhimin e personelit ndihmës akademik në funksion të këtij programi studimi. Fakulteti i Biznesit, si njësi kryesore, ka të angazhuar një personel ndihmës akademik prej 12 anëtarësh. Ky staf, veçanërisht sekretarja për programet master, sekretarja e departamentit, si dhe dy laborant IT ndihmojnë në realizimin e orëve laboratorike, si dhe në mirëmbajtjen e mjediseve mësimore, për këtë program studimi. Aktualisht në shërbim të këtij programi ka dy laboratorë</p>

<p>mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>mësimor ku mund të zhvillohen orët e laboratoreve të përfshira në kurrikulën e programit.</p> <p><i>Dokumenta shtesë_Tabela Ascal_MSC BF.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 87_Lista e laboratoreve dhe Kendi i studenteve.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 101_Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë gjatë vizitës në UAMD, GVJ konkludon se struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në Bankë-Financë, është Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike. Kjo drejtori funksionon bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Punës, Kodin e Proedurave Administrative, Ligji Nr. 80, datë 22.07. 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe Statuti dhe Rregullorja e Universitetit” Aleksandër Moisiu” Durrës.</p> <p>Gjatë vizitës pranë kësaj strukture, GVJ konstatoi se sektori i Burimeve Njerëzore mban të dhëna në formën e dosjeve personale (format letër) për të gjithë personelin me kohë të plotë ose me kontratë dhe i përditëson ato rregullisht mbi bazë vjetore. Nga verifikimi me zgjedhje i dy dosjeve personale pranë sektorit të Burimeve Njerëzore, përkatësisht një PAE dhe një PAK, GVJ konstatoi plotësinë e tyre. Përmbajtja e dosjes së personelit akademik: kontratë individuale; raport mjekësor; diplomat (bachelor, master, etj., si dhe listat e notave shoqëruese); dëshminë e penalitetit; CV; çertifikatë mbrojte e gjuhës së huaj, si edhe dokumenta të tjerë plotësues kryesisht të lidhura me kualifikime shkencore dhe akademike.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 180_Rregullore Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Juridike.pdf.pdf</i></p>

<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UAMD në nivel Institucional ka nënshkruar një numër të lartë marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor. Programi i studimit Master Shkencor në Bankë-Financë ka pjesë të kurrikulës zhvillimin e praktikës profesionale gjatë semestrit të dytë, të vitit të dytë.</p> <p>Departamenti i Financë-Kontabilitetit cakton një personel akademik përgjegjës për mbarëvajtjen e studentit gjatë praktikës mësimore (<i>neni 16, rregullore e programit të studimit</i>). Gjithashtu në institucionin ku zhvillohet praktika, studentit i caktohet një person mbikqyrës për realizimin me sukses të praktikës profesionale. Në përfundim të praktikës studenti përpilon një relacion për punën e kryer, së bashku me një vërtetim të nënshkruar nga titullari i institucionit ku është realizuar praktika. Relacioni i dorëzuar vlerësohet me notë nga komisioni i ngritur në departament.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, është i angazhuar për të asistuar studentët për të përgatitur tezën e diplomës. Për çdo student departamenti përcakton një staf akademik, drejtues të punimit shkencor (<i>neni 17, rregullore e programit të studimit</i>). Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga komisioni i ngritur në departament.</p> <p>Spektori i Karrierës dhe ALUMNI pranë Drejtorisë së administrimit dhe shërbimeve akademike në UAMD u ofron studentëve të këtij programi informacion në lidhje me mundësitë për realizimin e praktikave mësimore, kryesisht nëpërmjet lajmërimeve në web-in e UAMD, rrjete sociale, por edhe eventeve të tjera të organizuara si: panairi i karrierës (punës), histori suksesi, leksione me të ftuar, trajnime, etj. Gjithashtu gjatë takimit me studentët, doli në pah që informacion në lidhje me mundësinë për zhvillimin e praktikave mësimore (profesionale) ju ofrohen si nga zyra e karrierës, ashtu edhe nga stafi akademik që është i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë 27_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 45_Analiza e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023.pdf.pdf</i></p>
--	--

	<p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 83_Rregullore per praktikat mesimore.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 82 _Rregullore Diplomimi.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 196_Formular vlerësimi nga lektori udhëheqës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 200_Autorizim për paktikën mësimore_Master.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë ka pjesë të kurrikulës zhvillimin e praktikës profesionale gjatë semestrit të dytë, të vitit të dytë, për një periudhë tre muaj.</p> <p>Në përfundim të praktikës mësimore, bazuar në nenin 4, të rregullores për praktikat mësimore të Fakultetit të Biznesit, studenti dorëzon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formularin e vlerësimit nga pedagogu mbikqyrës; - Formularin e vlerësimit nga mbikqyrësi në kompaninë/institucionin ku zhvillon praktikën; - Raportin përfundimtar (relacion) të përgatitur nga studenti për punën e kryer gjatë praktikës. <p>Si pedagogu mbikqyrës, ashtu edhe mbikqyrësi në kompani/institucion angazhohen në rritjen e nivelit profesional të studentëve dhe në përfundim të praktikës bëjnë vlerësimin e studentit. Në përfundim të praktikës mësimore, studenti vlerësohet me notë.</p> <p><i>Evidencë 45_Analiza e Marrëveshjeve të bashkëpunimit me Departamenti Financë Kontabilitet, v.a 2022-2023.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 83_Rregullore per praktikat mesimore.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 200_Autorizim për paktikën mësimore_Master.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf.pdf</i></p>




<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në këtë program studimi, plotësojnë kushtet e kërkuara nga Ligji i arsimit të Lartë për nivelin e duhur profesional për natyrën dhe modulet e këtij programi.</i> - <i>Kurrikula e këtij programi mbulohet kryesisht me PAE. Stafit i angazhuar në këtë program studimi është shumë i qëndrueshëm, referuar si PAE, ashtu edhe PAK.</i> - <i>Institucioni ndjek procedurat e duhura të rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës akademik, duke përcaktuar kritere specifike në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij program studimi. Të dhënat e stafit ruhen konform të gjitha detyrimeve ligjore, si dhe përditësohen rregullisht.</i> - <i>Institucioni dhe Fakulteti i Biznesit ka nënshkruar një numër marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private. Zyra e karrierës dhe ALUMNI pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, si dhe personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, mundësojnë zhvillimin e praktikës mësimore profesionale, duke u siguruar që mbikqyrësi në vendin e praktikës të angazhohet në rritjen e nivelit profesional të studentit.</i> - <i>Çdo student mbyll ciklin e studimeve në të këtë program duke përgatitur një tezë diplome. Departamenti i Financë-Kontabilitetit, cakton një personeli akademik për të asistuar studentin në përgatitjen e tezës së diplomës. Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga komisioni i ngritur në këtë departament.</i> <p><i>Jo i gjithë personeli akademik, që angazhohet në këtë program studimi, plotësojnë kushtet e kërkuara nga Ligji i arsimit të Lartë për të dhënë mësim në IAL për nivelin e duhur të kualifikimit akademik për natyrën dhe modulet e këtij programi. Në këtë program studimi janë të angazhuar 3 personel akademik (2 PAE dhe 1 PAK) me Msc, megjithatë 2 prej tyre (PAE) janë në proces mbrojtjeje doktorature. Vetëm një staf akademik PAK, i angazhuar në mësimdhënie këto dy vitet e fundit, nuk është në proces mbrojtjeje doktorature.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Referuar RVB-së, UAMD zhvillon procesin mësimor në tre godina- një godinë në Currila dhe dy godina në Spitallë. Fakulteti i Biznesit i zhvillon programet e tij në godinën nr. 2 në Spitallë. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi ambiente të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të zhvilluar veprimtaritë mësimore të programit Master Shkencor në Bankë Financë, duke konsideruar kurrikulën e programit dhe numrin e studentëve. Për të mundësuar këtë program studimi, Fakulteti i Biznesit ka në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none">• 15 salla leksioni;• 1 sallë konference;• 2 laboratorë informatike;• 1 sallë biblioteke (e pozicionuar në godinën 1 në Spitallë);• zyra për stafin drejtues, personelin akademik dhe ndihmës akademik;• ambiente të tjera; <p><i>Evidencë 87_Lista e laboratoreve dhe Kendi i studenteve.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 101_Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë së lartë. Sallat ku zhvillohet mësimi janë të pajisur me PC dhe projektor të lëvizshëm, ndërkohë që laboratorët janë të pajisur me kompjutera, duke ju lehtësuar pedagogëve dhe studentëve procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në takimin me studentë u evidentua mundësia e përdorimit të sallave të laboratorëve edhe gjatë procesit të realizimit të detyrave të kursit dhe punimit të tezës së diplomës.</p>

<p>metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p><i>Evidencë 87_Lista e laboratoreve dhe Kendi i studenteve.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 101_Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë së lartë. Sallat ku zhvillohet mësimim janë të pajisur me PC dhe projektor të lëvizshëm, ndërkohë që laboratorët janë të pajisur me kompjutera, ku janë instaluar programet “Financë 5” dhe “E-views”, që ndihmojnë në aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve, duke plotësuar edhe objektivat kryesore të këtij program studimi.</p> <p><i>Evidencë 87_Lista e laboratoreve dhe Kendi i studenteve.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 101_Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit ka në përdorim 2 laboratorë, me 80 vende, të pajisur me kompjutera ku janë instaluar programet “Financë 5” dhe “E-views”, që ndihmojnë në aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve. Këtij fakulteti i është shtuar një Laborator Doktorature, në kuadër të një projekti të fituar pranë AKKSHI. Në kompjuterat e këtij laboratori janë të instaluar programet “E-views” dhe “SPSS” si dhe një program antiplagjaturë, gjë që do të ndikojë jo vetëm në rritjen e cilësisë së programit të doktoraturës, të programeve master të ofruar nga ky fakultet, por edhe në rritjen e nivelit dhe cilësisë të kërkimit shkencor të personelit akademik.</p> <p><i>Evidencë 101_Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 173_Raporti i AKKSHI për laboratorin e doktoraturës 12.10.2022.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të</p>	<p>N/A</p>

<p>bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni ofron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e këtij program studimi.</i> - <i>Mjediset mësimore janë të pajisur me mjete të teknologjisë së lartë në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë program.</i> - <i>Laboratorët mësimorë janë të pajisur me programe dhe software të nevojshëm dhe të përshtatshme për aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve.</i> - <i>Instalimi i programeve të avancuara në Laboratorin e Doktoraturës do të ndikoj në rritjen e nivelit të kërkimit shkencor në këtë fakultet, si dhe në rritjen e cilësisë së këtij program studimi.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në</p>	<p>Referuar dokumentave shoqëruese të RVB, GVJ konstatoi që për të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi vihet</p>




<p>dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>në dispozicion të studentëve literaturë kryesisht në gjuhën e programit (shqip), por ka edhe lëndë që ofrojnë literaturë të detyrueshme si në gjuhën shqip, edhe në gjuhën angleze, ashtu si edhe lëndë që ofrojnë literaturë të detyrueshme vetëm në gjuhën angleze. Ndërkohë literatura ndihmëse ofrohet si në gjuhën e programit dhe në gjuhë të huaj. Literatura në gjuhën shqip dhe në gjuhë të huaj (kryesisht në gjuhën angleze) ofrohet në formë fizike dhe digjitale pranë bibliotekës së këtij Institucioni.</p> <p><i>Dokumenta shitesë. Syllabuse Msc BF va 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB konkludon se literatura bazë jo gjithmonë është e përditësuar me botime të viteve të fundit. Këtu ndikon edhe fakti që duke pasur numër të ulët studentësh në nivelin Master, ribotimi i librave bëhet në periudha më të gjata kohe.</p> <p>Ndërkohë nuk ishte praktikë e zakoshme në departament, që pedagogët të bënin kërkesa për blerje libra të përditësuar që mund të shërbejnë si literaturë bazë, apo ndihmëse. Edhe në raportin: Relacion për aktivitetin e Bibliotekës në analizë evidentohet që për periudhën 2017-2020 nuk janë blerë libra për bibliotekë. <i>GVJ sugjeron shtimin e titujve fizikë në bibliotekë, duke konsideruar kërkesat e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi, minimalisht një herë në vit.</i></p> <p>GVJ duke konsideruar rëndësinë e madhe që ka literatura nga biblioteka online për studentë të programeve master shkencor, gjen si shumë të rëndësishëm regjistrimin në disa platforma elektronike (biblioteka online), duke u ofruar mundësinë për përditësim literature digjitale për studentët, si libra, ashtu edhe artikuj dhe punime shkencore.</p> <p><i>Dokumenta shitesë. Syllabuse Msc BF va 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf.pdf</i></p>

	<p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 123_Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 104_Aksesi online në bibliotekë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 103_Të dhënat për bibliotekën.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 110_Memo propozim per blerje librash.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 42_Informacion për Bibliotekën Online.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 41_Lista E-books e disponueshme.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar në këtë program studimi bibliotekën e cila ndodhet në katin e dytë të Godinës 1 në Spitallë. Studentët anëtarësohen nëpërmjet një kartelë regjistrimi (identifikimi), dhe mund të tërheqin nga biblioteka deri në 3 tituj njëkohësisht.</p> <p><i>Evidencë 109_Rregullorja e Bibliotekes.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në këtë bibliotekë dhe informacioni i marrë më pas, rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të Fakultetit të Biznesit si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj; botime e monografi; e cila mund të shfrytëzohet njëloj nga të gjithë studentët dhe stafi i universitetit. Megjithatë kjo literaturë është e kufizuar dhe e vogël në numër. <i>GVJ sugjeron që në literaturën fizike të bibliotekës, nevojitet investim i mëtijshëm.</i></p> <p><i>Evidencë 109_Rregullorja e Bibliotekes.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Aktualisht UAMD është i regjistruar në dy biblioteka online JStor dhe Ebsco, si dhe është pjesë e projektit të MASR për ofrimin e shërbimeve të bibliotekës on-line për universitetet publike "ULIBRARY". Studentët kanë mundësi të kërkojnë dhe aksesojnë libra, artikuj, studime, apo botime të tjera sipas fushës së interesit, si dhe moduleve të këtij programi studimi. GVJ e gjen me shumë vend, në kuadër të këtij program studimi, që</p>

	<p>është shtuar në mënyrë të konsiderueshme numri i titujve online në të cilin kanë akses studentët, pasi rrit cilësinë e programit, si dhe mundësinë e përdorimit të teknikave koherente dhe innovative në këtë proces mësimor-kërkimor.</p> <p><i>Evidencë 109_Rregullorja e Bibliotekes.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 42_Informacion për Bibliotekën Online.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 123_Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 41_Lista E-books e disponueshme.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ vizitoi ambjentet e Bibliotekës në godinën 1 në Spitalë, që i shërben Fakultetit të Biznesit dhe Fakultetit të Edukimit. Salla e bibliotekës ka internet dhe është e pajisur me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën elektronike, si dhe në katalogun e bibliotekës ku janë të regjistruar të gjithë titujt që ndodhen fizikisht në bibliotekë. GVJ iu konfirmua nga punonjësi i bibliotekës dhe studentët, se biblioteka frekuentohej vazhdimisht nga studentët jo vetëm për të tërhequr libra apo materiale mësimore por edhe si sallë studimi.</p> <p><i>Evidencë 109_Rregullorja e Bibliotekes.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 182_Informacion për Bibliotekën mbi evidencat për akreditimin institucional.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka ofron shërbimet për studentët në orare që përshtaten me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, për këtë program studimi. Për tu ardhur në ndihmë studentëve biblioteka ofron shërbim edhe gjatë fundjavës. Orari i bibliotekës, 8:00-16:00 nga e Hëna në të Djelë është i afishuar edhe në website e UAMD.</p> <p><i>Evidencë 109_Rregullorja e Bibliotekes.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 120_Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt</p>	<p>Referuar RVB, institucioni informohet për nevojat për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me titujt të rinj në mbështetje të programeve të studimit. Megjithatë nga vizita në institucion u konstatua që pasurimi i fondit fizik ka qenë i kufizuar. Në relacionin për aktivitetin e Bibliotekës në analizë evidentohet që për periudhën 2017-2020 nuk janë blerë libra për</p>

<p>kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>bibliotekë. <i>GVJ sugjeron shtimin e titujve fizikë në bibliotekë, duke konsideruar kërkesat e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi, minimalisht një herë në vit.</i></p> <p>Regjistrimi në disa platforma elektronike (biblioteka online) ofron mundësinë për përditësim literature digjitale për studentët. GVJ e gjen me shumë vend, në kuadër të këtij program studimi, shtimin e numrit të titujve online në të cilin kanë akses studentët, pasi rrit cilësinë e programit, si dhe mundësinë e përdorimit të teknikave koherente dhe inovative në këtë proces mësimor-kërkimor.</p> <p><i>Evidencë 109_Rregullorja e Bibliotekes.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 42_Informacion për Bibliotekën Online.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 123_Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 41_Lista E-books e disponueshme.pdf.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve literaturë bazë në gjuhën e programit dhe shpesh edhe në gjuhë të huaj, si dhe literaturë ndihmëse në gjuhën e programit dhe në gjuhë të huaj për të gjitha lëndët e kurrikulës.</i> - <i>Biblioteka fizike dhe online vihet në dispozicion të të gjithë studentëve në mënyrë të barabartë, pa pagesë dhe në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor për këtë program studimi. Institucioni ka mundësuar ofrimin e këtij shërbimi edhe gjatë fundjavës.</i> - <i>Salla e bibliotekës ka internet dhe është e pajisur me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën elektronike, si dhe në katalogun e bibliotekës ku janë të regjistruar të gjithë titujt që ndodhen fizikisht në bibliotekë.</i> - <i>Përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse bëhet kryesisht nëpërmjet platformave online. GVJ e gjen me shumë vend, në kuadër të këtij program studimi, shtimin e numrit të titujve online në të cilin kanë akses studentët, pasi rrit cilësinë e programit, si dhe mundësinë e përdorimit të teknikave koherente dhe inovative në këtë proces mësimor-kërkimor.</i>


	<i>GVJ sugjeron shtimin e titujve fizikë në bibliotekë, duke konsideruar kërkesat e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi, minimalisht një herë në vit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se sistemi i menaxhimit në këtë institucion konsiston në Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, Sekretarinë Mësimore si dhe Sistemit të kompjuterizuar “Pitagora”. Ky sistem kompjuterik administrojnë informacionin për studentët që nga regjistrimi i tyre deri në mbylljen e programit të studimit. Informacioni për studentët konsiston kryesisht në të dhëna personale dhe vlerësime me nota. Ndërkohë sekretaria mësimore është struktura që administrojnë të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi. Gjatë vizitës në sekretari GVJ-ja verifikoi me zgjedhje dosjen e plotë të dy studentëve të programit të studimit Master në Bankë-Financë dhe përdorimin e regjistrave përkatës sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. <i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf.pdf</i> <i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarisë Mesimore në FB.pdf.pdf</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, Rregullores së UAMD-së dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstatoi se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Bankë- Financë realizohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike në formën e dosjes personale të personelit, si dhe departamenti i Financë-Kontabilitetit

<p>partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>përgjegjës për këtë program studimi, në formën e dosjes së kërkimit shkencor.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 180_Rregullore Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Juridike.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dërguar nga Institucioni dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në UAMD, GVJ-ja konstatoi se platforma “Pitagora” është e organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë. Aktualisht shkëmbimet e informacionit ndërmjet përdoruesve të platformës përqendrohen kryesisht në përdorimin e platformës për konsultimin e informacioneve apo dokumenteve si syllabuset e çdo lënde, materialet e ofruara nga pedagogët e lëndës, frekuentimi i studentëve, vlerësimi i vazhduar, listat e notave dhe krediteve. Komunikimi (personel akademik, studentë, personel joakademik) realizohet edhe nëpërmjet adresave elektronike të emailit me domain uamd.edu.al. Komunikimi nëpërmjet rrjeteve sociale është një formë tjetër interaktive në funksion të lehtësimit të këtij program studimi.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ-ja konstaton se platforma “Pitagora” është e organizuar për të ofruar akses të dedikuar për të gjitha kategoritë e përdoruesve të planifikuar në këtë platformë. Përdorimi i platformave online Google Classroom dhe Teams, nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi ofron mundësi më të mëdha për një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, ofrim materiale, si dhe realizim të Quizz-ve, Assignments, Case studies, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>




	<p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 66_Metodat interaktive të përdorura për mësimdhënie përfundimtare, shkurt 2023.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Aktet rregullatore të institucionit sigurojnë monitorimin e aktivitetit akademik e administrativ. Aktiviteti mësimor monitorohet nëpërmjet rregjistrit mësimor i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga pedagogu i lëndës, në fillim dhe mbarim të procesit mësimor. Në rast mungese bëhet njoftimi i drejtuesit të njësisë bazë, si dhe plotësohet formulari për zëvendësimin e mësimit. Kontrollë të rastësishme në lidhje me zhvillimin e mësimit bëhen nga njësia bazë, njësia kryesore si dhe nga njësia e sigurimit të cilësisë. Aktiviteti i sekretarisë mësimore mbikqyret nga Zv/dekani për anën mësimore dhe realizohet në bazë të rregullores së fakultetit dhe rregullores së sekretarisë mësimore. GVJ konstaton se në tërësi sistemi i menaxhimit të UAMD bëhet në mënyrë të dokumentar duke respektuar aktet rregullatore të institucionit dhe garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarise Mesimore ne FB.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Pas konsultimit të website të UAMD, GVJ konstatoi se janë bërë publike informacione që lidhen me programin e studimit, njësinë bazë që ofron programin e studimit, personelin akademik, si dhe një sërë informacione dhe aktivitete të tjera publikohen në faqen e internetit në gjuhën shqip, si edhe në dy gjuhë të huaja- anglisht dhe italisht. GVJ konstaton që informacioni në faqen e web-it nuk është lehtësisht i aksesueshëm, për shkak të mënyrës së organizimit të rubrikave në këtë website. Në një nënrubrikë është përqëndruar pjesa më e konsiderueshme e informacionit të</p>

	<p>këtij institucioni. Gjithashtu një numër i madh dokumentash të publikuara në këtë website nuk kanë në përmbajtje informacion që lidhet me emërtimin e dokumentit.</p> <p><i>GVJ sugjeron riorganizim e rubrikave të website të UAMD dhe ngarkimin e dokumentave të duhura në rubrikat përkatëse.</i></p> <p><i>Referenca: www.uamd.edu.al</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni disponon sistem menaxhimi efektiv nëpërmjet të cilit administron informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</i> - <i>Sistemi i menaxhimit ka të integruar disa platforma të cilat mundësojnë një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i> - <i>Informacionet në website e UAMD-së publikohen në tre gjuhë, por informacioni nuk është lehtësisht i aksesueshëm.</i> <p><i>GVJ sugjeron riorganizim e rubrikave të website të UAMD dhe ngarkimin e dokumentave dhe informacionit të duhur në rubrikat përkatëse.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen	Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe qëndrueshmërinë e programit të studimit. GVJ mbështetur në dokumentat shoqëruese të RVB dhe vizitën në institucion konstatoi se UAMD harton planin financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron ky institucion. Çdo njësi bazë përgatit projekt buxhetin

<p>e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>bazuar në nevojat për mbulimin e programeve të studimit që ofron. Bazuar në këto projektbuxhete hartohet projekt buxheti për institucionin, në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit të tij.</p> <p><i>Evidencë 113_Miratimi i Buxhetit Vjetor 2020-2021.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 117_Projektbuxheti 2023-2025 Dep. FK.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 140_VKM Nr. 780 Ulje tarife Cikli i Dytë Master.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Mbështetur në statutin e UAMD projektbuxheti i vitit pasardhës hartohet në përputhje me propozimet e bëra prej njësisë kryesore dhe njësisë bazë dhe në zbatim të planit buxhetor afatmesëm të miratuar nga Bordi i Administrimit dhe Senati. Në raportet financiare shpenzimet janë të klasifikuara kryesisht sipas natyrës së tyre, ndërsa të ardhurat janë të klasifikuara sipas burimeve të parashikuara të financimit (në statutin e UAMD): të ardhura nga buxheti i shtetit, pagesat e studentëve për arsimim, të ardhura për shërbimet e kryera, të ardhura nga marrdhëniet me palët e treta, të ardhura nga donacione dhe burime të ligjshme financimi, të ardhura nga veprimtari kërkimore shkencore dhe të ardhura nga projekte lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. GVJ mbështetur në dokumentat shoqëruese të RVB dhe vizitës në institucion konstatoi se nuk janë shpenzuar një pjesë e mirë e fondeve për kërkim shkencor (për 9 mujorin e parë të vitit 2022 janë shpenzuar vetëm 22% e fondeve të planifikuara).</p> <p>Ndërkohë GVJ konstatoi se është aplikuar dhe janë fituar fonde për donacion në kuadër të ngritjes së laboratorit të doktoratues, blerje të platformave online në funksion të rritjes së kërkimit shkencor, si dhe investimit për rritje të eficiencës së analizës së pyetorëve në funksion të sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Evidencë 113_Miratimi i Buxhetit Vjetor 2020-2021.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se pranë UAMD funksionon një njësi e auditit të brendshëm, e cila bazuar në Statutin e Institucionit është krijuar me vendim të Bordit të Administrimit, dhe funksionon bazuar në udhëzuesin e hartuar prej tij, si dhe bazuar në procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Kjo njësi kryen auditim të brendshëm sipas procedurave ligjore. Në këtë kuadër,</p>

	<p>institucioni ka hartuar Kartën e Auditit të Brendshëm e cila miratohet nga Bordi i Administrimit.</p> <p>UAMD si çdo institucion tjetër publik është subjekt auditimi të jashtëm nga KLSH. Nga verifikimi i faqes web të Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk rezultoi ndonjë auditim i publikuar mbi UAMD për periudhën 2019-2023. Ndërkohë në materialet shoqërues të RVB është bashkëngjitur një raport auditimi i brendshëm për vitin 2020 për UAMD, por ky raport ka shumë pak detajime në lidhje me gjetjet e bëra, si dhe sugjerimet përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 118_Raporti Vjetor i Auditit të brendshëm (Karta auditit te brendshem, pyetesori i vetevleresimit te AB raporti vjetor, formati i raportimit 2020).pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentat shoqëruese të RVB dhe vizitën në institucion konstatoi se UAMD harton planin financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron ky institucion. Çdo njësi bazë përgatit projekt buxhetin bazuar në nevojat për mbulimin e programeve të studimit që ofron. Bazuar në këto projektbuxhete hartohet projekt buxheti për institucionin, në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit të tij. Gjithashtu konstatohet që bëhet një analizë mbi realizimin e buxhetit të miratuar për vitin e kaluar- analizë plan/ fakt.</p> <p><i>Evidencë 113_Miratimi i Buxhetit Vjetor 2020-2021.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 117_Projektbuxheti 2023-2025 Dep. FK.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të</p>	<p>Referuar statutit të UAMD burimet e financimit të universitetit konsistojnë në: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimimin; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore.</p> <p>Udhëzimi i MF “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” përcakton se fondet e buxhetit të shtetit për arsimin e lartë janë në formën e grantit që për çdo universitet shpërndahet në fillim të vitit buxhetor nga MASR. Më pas universitetet nëpërmjet organeve kolegjiale e detajojnë këtë grant sipas njësisë shpenzuese dhe zërave përkatës të buxhetit të planifikuar prej tyre. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi</p>

<p>financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>se për periudhën 2019-2022 ecuria e të ardhurave të realizuara paraqitet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Viti 2021 rreth 23,1% fonde të UAMD dhe 76,9% granti nga MASR; ▪ Viti 2020 rreth 20,6% fonde të UAMD dhe 79,4% granti nga MASR; <p>Nga shqyrtimi i informacionit mbi buxhetin paraqitur në dokumentacionin shoqërues të RVB, GVJ konstaton se vlera e shpenzimeve për kërkimin shkencor është shumë e vogël, krahasuar me planifikimin.</p> <p>Në dokumentat shoqëruese nuk ka një raport mbi analizën e qëndrueshmërisë financiare të Institucionit. <i>GVJ sugjeron kryerjen e një analize qëndrueshmërie financiare, për këtë program studimi dhe Departamentin e Financë- Kontabilitetit.</i> Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi paraqitet ne tabelën e mëposhtme.</p> <table border="1" data-bbox="603 1039 1394 1155"> <thead> <tr> <th>2019-2020</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>24</td> <td>20</td> <td>18</td> <td>22</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në dokumentat shtesë që u kërkuan nga GVJ-ja, për analizën e qëndrueshmërisë financiare, është paraqitur një analizë e thjeshtë financiare, por që merr në konsideratë 80 studentë në vit, kur tashmë (në këto 4 vitet e fundit) numri i studentëve është përgjysmuar.</p> <p><i>Evidencë 113_Miratimi i Buxhetit Vjetor 2020-2021.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 117_Projektbuxheti 2023-2025 Dep. FK.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf.pdf</i></p> <p><i>Materiale shtesë_Plani Financiar i MSC BF.pdf</i></p>	2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023	24	20	18	22
2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023						
24	20	18	22						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Pranë UAMD funksionon një njësi e auditit të brendshëm, e cila kryen auditim të brendshëm periodik sipas procedurave ligjore.</i> - <i>UAMD si institucion buxhetor, i financuar kryesisht nga të ardhurat publike, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.</i> 								

	<i>Megjithatë, megjë nuk konstatuam një analizë të mirëfilltë të qëndrueshmërisë financiare të institucionit, GVJ sugjeron kryerjen e një analize qëndrueshmërie financiare si për Institucionin, por edhe për Departamentin e Financë-Kontabilitetit, dhe specifikisht për këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe nga faqja web e UAMD, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. <i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i> <i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i> <i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i> <i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf.pdf</i> <i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf.pdf</i>

<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Barazia e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohej nga statuti i UAMD, rregullore e Fakultetit të Biznesit, rregullore e Departamentit të Financë-Kontabilitetit dhe rregullore e Programit të studimit Bankë-Financë. Në rregulloren e programit të studimit është përcaktuar që pranohen në këtë program studimi kandidatët të cilët kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të IAL-së ku aplikojnë. Kuotat dhe kriteret e pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve fitues përcaktohen nga Departamentit i Financë-Kontabilitetit, miratohen nga Dekani i Fakultetit të Biznesit, dhe i përcillen Senatit akademik. Senati akademik miraton propozimin dhe ia përcjell MAS dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore para fillimit të aplikimeve për pranime. Pranë Departamentit të Financë -Kontabilitetit ngrihet nga Dekani i FB një komision për përzgjedhjen e kandidatëve fitues, bazuar në pikët e grumbulluara nga vlerësimi i dosjes së aplikimit për këtë program studimi. Gjithashtu në njësinë bazë ngrihen edhe komisione për marrje vendimi për transferime dhe ekuivalentim studimesh.</p>
	<p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf.pdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf.pdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 143_Komisione Ad Hoc_Aplikime Master 2022-2023.pdf.pdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 65_Kritere Pranimi programet e studimit ndërvite.pdf.pdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 63_Komision Ad Hoc per transferim_Kriteret e transferimit_Vendim Nr. 14 datë 04.09.2020.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Financë-Kontabilitetit, si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi përcakton kuotat e pranimit, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për këtë cikël studimesh, çdo vit,</p>

<p>Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>përpara datës 10 dhjetor të vitit paraardhës akademik (neni 39, pika 6 e rregullores së FB) dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Njësia kryesore ka për detyrë të bëjë publike këto kritere (neni 39, pika 7 e rregullores së FB).</p> <p><i>Evidencë 65_Kritere Pranimi programet e studimit ndër vite.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, si dhe konsultimit të faqes web të UAMD, GVJ konstatoi se kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, procedurave të transferimit, njohjes së plotë ose të pjesshme të studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme nga publiku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në sekretarinë mësimore të Fakultetit të Biznesit; - Afishimit të informacionit në stenda në ambientet e Fakultetit të Biznesit dhe në godinat e tjera ku zhvillon aktivitetin UAMD; - Faqen web të UAMD; <p><i>Referenca: www.uamd.edu.al; vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Informimi i të gjithë të interesuarve në lidhje me UAMD, programet e studimit dhe kriteret e pranimit në to, realizohet nëpërmjet fushatës sensibilizuese për tërheqjen e kandidatëve për studentë në këtë program studimi. Zakonisht kjo fushatë konsiston në takimet e programuara me studentë që ndjekin studimet e nivelit Bachelor pranë UAMD, pjesmarrjes në konferenca të ndryshme studentore, si edhe nëpërmjet fushatës sensibilizuese në web-in e UAMD, si dhe nëpërmjet adresave të rrjeteve sociale që manaxhohen nga njësitë drejtuese përkatëse për secilin program studimi. Gjatë vizitës në institucion na u komunikua që përveç zyrës së Karrierës dhe Alumni, një rol të rëndësishëm në këtë fushatë sensibilizuese jep edhe njësia bazë që ofron këtë program studimi. Mbahet parasysh që i gjithë</p>

	<p>informacioni që ofrohet gjatë fushatës sensibilizuese të jetë i publikuar në faqen web të UAMD.</p> <p><i>Evidencë 143_Komisione Ad Hoc_Aplikime Master 2022-2023.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 65_Kritere Pranimi programet e studimit ndër vite.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 63_Komision Ad Hoc per transferim_Kriteret e transferimit_Vendim Nr. 14 datë 04.09.2020.pdf.pdf</i></p> <p>www.uamd.edu.al</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ konstanton se në Evidencën 65- Kritere pranimi në programet e studimit ndër vite, Dekani i Fakultetit të Biznesit ka të përcaktuar një komision Ad-hoc të veçantë që shqyrton aplikimet për kandidatë me aftësi të veçanta, jetimë, komuniteti rom dhe ai egjiptian, shtetasit e huaj si dhe për shqiptarët e trojeve.</p> <p><i>Evidencë 65_Kritere Pranimi programet e studimit ndër vite.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 63_Komision Ad Hoc per transferim_Kriteret e transferimit_Vendim Nr. 14 datë 04.09.2020.pdf.pdf</i></p> <p>www.uamd.edu.al</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ konstanton se në rregulloren e Fakultetit të Biznesit për pranimet në ciklin e dytë Master (neni 39, pika 8), është e parashikuar që kanë të drejtë të pranohen në këtë program studimi edhe kandidatët që kanë fituar një diplomë studimi të një vendi të huaj të vlerësuar e të barasvlefshme me të. Kriteret dhe rregullat për përzgjedhje janë të njëjta si për kandidatët e tjerë, dhe vlerësohen nga një komision ad-hoc që ngrihet nga njësia bazë.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 65_Kritere Pranimi programet e studimit ndër vite.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 63_Komision Ad Hoc per transferim_Kriteret e transferimit_Vendim Nr. 14 datë 04.09.2020.pdf.pdf</i></p> <p>www.uamd.edu.al</p>




<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Referuar RVB, institucioni bazohet në udhëzimet dhe vendimet e qeverisë për politikatat e ndihmës/bursave për shtresa në nevojë. Ky institucion bën publike në faqen web të institucionit kriteret dhe sqarime të tjera për përfituesit e bursave, referuar vendimeve dhe udhëzimeve të qeverisë, si dhe mënyrës së administrimit të tyre.</p> <p>[Referenca: www.uamd.edu.al]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstanton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. - Institucioni publikon përpara fillimit të çdo viti akademik, kriteret dhe procedurat e pranimit në programin e studimit duke garantuar akses në informacion dhe barazi në procesin e pranimit të aplikimeve dhe të përzgjedhjes për të gjithë kandidatët. - Dekani i Fakultetit të Biznesit, ngre komision ad-hoc që trajton aplikimet nga personat me aftësi të veçanta, grupeve të marginalizuara, shtetasit e huaj, si dhe shtetasit shqiptarë që vijnë nga trojet. 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UAMD, GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve dhe moduleve të mëparëshme në rast transferimi studimesh. Këto kritere dhe procedura janë pjesë e</p>

<p>kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Rregullores së UAMD, rregullores së Fakultetit të Biznesit dhe veçanërisht të Rregullores së programit të studimit. Rregullore e UAMD është e publikuar në faqen zyrtare web të institucionit.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Referuar Rregullores së programit të studimit dhe rregullores së Fakultetit të Biznesit, GVJ konstatoi se studentit i ofrohet mundësia për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, si brenda institucionit ashtu edhe nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë për transferimet, si dhe në rregulloren e programit të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Njësia bazë ngre një komision ad-hoc i cili merr vendimin për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet. Kreditet minimale të domosdoshme për transferimin e studimeve janë 30 kredite të fituara. Lënda apo moduli në programin Master ekuivalentohet (referuar nenit 10, pika 3 të rregullores së programit të studimit) nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ka emërtim të njëjtë ose të ngjashëm; - trajton tema të njëjta ose të ngjashme dhe ka përputhje të ngarkesës në auditor në masën mbi 70%; <p>Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore u kërkua dosja e një studenti të transferuar të zgjedhur nga GVJ në mënyrë rastësore dhe dosja rezultoi e plotë, si dhe ishin ndërmarrë të gjithë hapat e përmendur më sipër gjatë procedurës së transferimit.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf.pdf</i></p>




	<p><i>Evidencë 58_Kriteret e transferimeve për departamentin e Financë Kontabilitetit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 63_Komision Ad Hoc per transferim_Kriteret e transferimit_Vendim Nr. 14 datë 04.09.2020.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konkludoi që studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit dhe Rregullores së Fakultetit të Biznesit. Në orën e parë të fillimit të procesit mësimor për secilën lëndë, studentëve ju ofrohet informacion nga pedagogu për syllabusin e lëndës, detyrimeve për tu përmbushur si edhe mënyrën e vlerësimit.</p> <p>Shkalla e përvetësimit të programit mësimor të lëndës vlerësohet me një sistem pikëzimi 1'000 pikësh, i cili konvertohet në notë në procesverbalin përfundimtar. Bazuar në rregulloret e mësipërme, si dhe nga verifikimi i syllabuseve, GVJ konstatoi se vlerësimi i dijeve të studentëve kryhet në mënyrë të njëjtë për të gjitha lëndët e kurrikulës së këtij programi duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyra, projekte, ese etj. – 10% të vlerësimit total; • Provim i ndërmjetëm – 40% të vlerësimit total; • Provimit përfundimtar - 50% të vlerësimit total. <p>Nëse studenti nuk frekuenton 25% të lëndës, ai klasifikohet që nuk ka frekuentuar lëndën, vlerësohet me notën 4 dhe duhet të frekuentojë lëndën vitin pasardhës.</p> <p><u>GVJ sugjeron:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Të ketë më tepër fleksibilitet për pedagogun e lëndës në ndarjen e pikëve për vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar, në respektim të përmbajtjes së lëndës, metodave të mësimdhënies së përdorur, si dhe të lirisë akademike.</i> - <i>Të mos bëhet vlerësimi me notë jokaluese në rast se studenti klasifikohet “nuk ka frekuentuar lëndën”, përderisa studenti nuk testohet për programin e lëndës.</i>
	<p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf.pdf</i></p>




	<p><i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarise Mesimore ne FB.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Materiale shtesë: Syllabuse Msc BF va 2022-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB, rregullores së diplomimit të UAMD, rregullores së programit të studimit dhe vizitës në institucion, GVJ konkludoi që studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e diplomimit për këtë program studimi. Procedura e mbrojtjes së diplomës, për studentët e programit Master i Shkencave në Bankë- Financë është vetëm me mbrojtje tezë diplome.</p> <p>Drejtuesit e tezave të diplomës propozohen nga njësia bazë dhe aprovohen nga drejtuesi i njësisë kryesore. Tema e diplomës duhet të përkojë me fushat e kërkimit të departamentit. Studenti, mbasi ka përmbushur të gjitha detyrimet për të dy vitet akademike, dorëzon Kërkesën për tu regjistruar në Mbrojtjen e Tezës së Diplomës, pranë sekretarisë mësimore të departamentit. Punimi/ provimi i diplomës vlerësohen me notë, nga komisioni i ngritur nga njësia bazë. Referuar takimit me studentët gjatë vizitës në institucion, studentët ishin të mirëinformuar për mënyrën dhe procedurat e diplomimit, gjatë viteve të studimeve.</p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarise Mesimore ne FB.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 82_Rregullore Diplomimi.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 89_Orientimi i studenteve per Praktiken dhe Mikrotezen_Material Shpjegues.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë gjatë vizitës në institucion, si dhe në faqen ëeb të UAMD, GVJ konstatoi se Institucioni realizon aktivitete si: fushatë sensibilizuese me studentët që aktualisht ndjekin studimet bachelor në UAMD, panair pun, “histori suksesi”, afishim të informacionit në mjediset e UAMD, komunikim në rrjetet sociale, si edhe publikim në faqen web të UAMD për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi këtë dhe programe tw tjera studimi qw ofron Institucioni.</p> <p><i>Evidencë 39_Alumni Network FB Raport.pdf.pdf</i></p>

	https://uamd.edu.al			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre, transferimit të studimeve si dhe njohjes së kualifikimeve të mëparëshme në rast transferimi studimesh.</i> - <i>Institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit, praktikës profesionale, si dhe përmblylljes së tyre me tezë diplome.</i> - <i>Institucioni realizon një numër aktiviteteve dhe ofron informacion duke informuar përpara fillimit të çdo viti akademik të interesuarit dhe studentët e ardhshëm për programet e studimit.</i> <p><u><i>GVJ sugjeron:</i></u></p> <p><i>Të ketë më tepër fleksibilitet për pedagogun e lëndës në ndarjen e pikëve për vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar, në respektim të përmbajtjes së lëndës, metodave të mësimdhënies së përdorur, si dhe në respektim të lirisë akademike.</i></p> <p><i>Të mos bëhet vlerësimi me notë jokaluese, përderisa studenti nuk testohet për programin e lëndës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Referuar RVB, vizitës në institucion, si dhe faqes web të UAMD, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë informohen në fillim të studimeve nga pedagogët që janë të angazhuar në këtë program studimi, si dhe sekretaria mësimore e Fakultetit të Biznesit për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe

	<p>elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. Informacion ofrohet edhe në faqen web të UAMD si edhe në rrjetet sociale, që administrohen nga njësia bazë.</p> <p><i>Referenca: https://uamd.edu.al; vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët e këtij program studimi marrin informacion më të detajuar për të gjithë elementët lidhur me modulet e kurrikulës së programit, gjatë prezantimit të orës së parë të mësimit nga pedagogët e lëndës. Informacion të detajuar studentët mund të gjejnë edhe në: sekretarinë mësimore, faqen web të UAMD, afishimeve në ambientet e Fakultetit të Biznesit, rrjeteve sociale, si edhe komunikimit me pedagogët e angazhuar në këtë program studimi në klasat virtuale të krijuara prej tyre (google classroom, teams).</p> <p><i>Materiale shtesë: Syllabuse Msc BF va 2022-2023.pdf</i> <i>https://uamd.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësuesit e Sektorit të Alumnit dhe Karrierës, gjatë vizitës në institucion, rezultoi se kjo strukturë kujdese kryesisht për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit si dhe mundësitë për internship. Kjo zyrë ka në fokus ofrimin e trajnimeve për studentët për ti përgatitur për të aplikuar për punësim, si dhe organizon evente në funksion të punësimit. Panairi i punës dhe aktiviteti “histori suksesi” të lidhura me rrjetin Alumni ishin aktivitetet që ndikojnë më tepër në punësimin e studentëve. Gjatë vizitës në institucion dhe veçanërisht gjatë takimit me studentë, doli në pah se informacion për punësim u ofrohej edhe nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi, dhe nga Departamenti i Financë- Kontabilitetit, përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë 39_Alumni Network FB Raport.pdf.pdf</i> <i>https://uamd.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se, pedagogët e departamentit të Financë-Kontabilitetit, në javën e parë të fillimit të studimeve, pedagogët e angazhuar në këtë program studimi në orën e parë të fillimit të lëndës së tyre, sekretaria mësimore, si dhe në mënyrë më të dedikuar Koordinatori për programin e studimit, luajnë një rol kyç në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p>

	<p>Faqja web e UAMD si dhe rrjetet sociale luajnë gjithashtu një rol thelbësor në ofrimin dhe përditësimin e informacionit në lidhje me elementë të rëndësishëm të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidencë 53_Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.pdf.pdf</i></p> <p>https://uamd.edu.al</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nëpërmjet faqes Web të UAMD-se dhe hapësirës së dedikuar në platformën “Pitagora”, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, të konsultojnë vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar sipas lëndëve që kanë frekuentuar, orarin e provimeve, etj, si dhe të informohen lidhur me infrastrukturën dhe aktivitete të tjera të organizuara në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe universiteti.</p> <p><i>Referenca: https://uamd.edu.al</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Studentët informohen në fillim të vitit akademik, si dhe gjatë gjithë periudhës së studimeve për të gjithë detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor si edhe elementët ndihmës në funksion të tij.</i> - <i>Zyra e Karrierës dhe Alumni, si dhe pedagogët e departamentit të Financë-Kontabilitetit, ofrojnë informacion për mundësitë e punësimit të studentëve.</i> - <i>Studentët janë të përditësuar dhe kanë si akses fizik ashtu edhe online, në informacionin në lidhje me procesin mësimor, inrastrukturën, logjistikën dhe elementë të tjerë mbështetës të tij.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike pranë UAMD është njësia që kujdeset për mbajtjen e të dhënave dhe përpunimin statistikor vjetor për numrin e studentëve e të diplomuarve, në të gjithë programet e studimit të ofruar nga institucioni. Të dhënat për këtë drejtori ofrohen nga kryesekretaret e sekretarisë mësimore të çdo fakulteti. Pra për këtë program studimi, të dhënat për studentët ofrohen nga kryesekretarja e sekretarisë mësimore të Fakultetit të Biznesit dhe përpunohen statistikisht, nga zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, bazuar në rregulloren e kësaj të fundit.</p> <p><i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf.pdf</i></p> <p><i>Materiale shtesë_Tabela me mesataret ne hyrje dhe ne dalje per studentet MSC BF.pdf</i></p> <p><i>Materiale shtesë_Tabelat MSC BF_.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore e Fakultetit të Biznesit mbledh, regjistron dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të tyre gjatë ciklit të studimeve dhe diplomimin e tyre. Regjistrat në sekretari (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i lëshimit të diplomave) janë të formatuar sipas standardeve shtetërore. Pranë sekretarisë depozitohet edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit Master Shkencor në Bankë-Financë dhe konstatoi plotësinë e tyre.</p>
	<p>Të dhëna për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi janë:</p>




	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të transferuarve	Nr Aktual	Nr i të diplomuarve
	2019-2020	24	0	24	21
	2020-2021	20	0	20	25
	2021-2022	18	0	18	21
	2022-2023	22	0	22	22
	<p><i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf.pdf</i></p> <p><i>Materiale shitesë_Tabelat MSC BF_.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf.pdf</i></p>				
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UAMD. Pranë sekretarisë mësimore informacioni ruhet në formatin letër (versioni hard copy) dhe në sistemin e menaxhimit informatik ruhet në versionin elektronik (soft copy). Të dy mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësit e çdo strukture të UAMD-së, që merren me përpunimin e të dhënave personale bazohen në kriteret e përcaktuara në nenin 6 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe veçanërisht në nenet 15-20 të rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale të UAMD.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarisë Mesimore ne FB.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 10_Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UAMD.pdf.pdf</i></p>				

<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Referuar RVB, Statutit të UAMD dhe Ligjit të Arsimit të Lartë (80/2015) njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit janë Sekretaria Mësimore dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike. Institucioni ka hartuar rregulloret përkatëse për këto njësi, si dhe periodikisht ushtron kontroll nga Fakulteti i Biznesit dhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarise Mesimore ne FB.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p>															
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti i Financë-Kontabilitetit analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për secilin program studimi (statistika referuar notës mesatare në hyrje dhe në dalje të studentëve). Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së departamentit për vitin akademik, e cila mbyllet me problematikat dhe shoqërohet me rekomandime për përmirësime.</p> <table border="1" data-bbox="596 1312 1394 1541"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Mesatarja në hyrje</th> <th>Mesatarja në dalje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>6,75</td> <td>8,43</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>6,84</td> <td>7,65</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>6,34</td> <td>8,38</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjithashtu, zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, mbledh informacion në lidhje me punësimin e të diplomuarve dhe ia kalon këtë informacion Drejtorit të njësisë bazë, përgjegjës për këtë program studimi.</p>	Viti akademik	Mesatarja në hyrje	Mesatarja në dalje	2020-2021	6,75	8,43	2021-2022	6,84	7,65	2022-2023	6,34	8,38			
Viti akademik	Mesatarja në hyrje	Mesatarja në dalje														
2020-2021	6,75	8,43														
2021-2022	6,84	7,65														
2022-2023	6,34	8,38														
	<table border="1" data-bbox="596 1765 1394 1968"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të diplomuar</th> <th>Punësuar në profil</th> <th>Punësuar jo në profil</th> <th>Punësuar total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>21</td> <td>16</td> <td>3</td> <td>19</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>25</td> <td>18</td> <td>1</td> <td>19</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Të diplomuar	Punësuar në profil	Punësuar jo në profil	Punësuar total	2019-2020	21	16	3	19	2020-2021	25	18	1	19
Viti akademik	Të diplomuar	Punësuar në profil	Punësuar jo në profil	Punësuar total												
2019-2020	21	16	3	19												
2020-2021	25	18	1	19												

	2021-2022	21	15	2	17
	<p><i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf.pdf</i></p> <p><i>Materiale shitesë_Tabela me mesataret ne hyrje dhe ne dalje per studentet MSC BF.pdf</i></p> <p><i>Materiale shitesë_Tabelat MSC BF_.pdf</i></p>				
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UAMD mban dhe disponon statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar, diplomuar dhe punësuar sipas programeve dhe cikleve të studimit.</i> - <i>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke siguruar respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</i> - <i>Departamenti i Financë-Kontabilitetit përgjegjës për këtë program studimi analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, punësimin e tyre, duke nxjerrë rekomandimet në funksion të rritjes së cilësisë së programit.</i> 				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X	

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se UAMD bazuar në Rregulloren e UAMD (neni 115) si dhe Statutin e UAMD u mundëson studentëve përfaqësimin në organet e UAMD, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Ata marrin pjesë në të gjitha proceset

<p>ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>e vendimmarrjes së UAMD-së, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore. Gjithashtu rregullorja e Fakultetit të Biznesit (neni 84) u mundëson studentëve përfaqësimin në organet e Fakultetit të Biznesit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 146_Shkresë_Për zgjedhjen e studentëve për anëtar Bordi.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton se aktualisht UAMD përdor sistemin e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve realizohet nga zyra e NJSBC dhe përfundon me hartimin e Raportit të Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve (vlerësim me %), i cili u komunikohet organeve drejtuese, individualisht secilit prej pedagogëve, dhe më pas përgjegjësit të njësisë bazë për të analizuar rezultatet dhe marrjen e masave përkatëse. Gjithashtu departamenti i Financë-Kontabilitetit, përgjegjës për këtë program studimi mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe kordinatorit të programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BsC MsC MP.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 131_Pyetësor mbi rezultatet e anketimit të studentëve, të stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin, v.a 2017-2018.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 75_Email - Mbledhje Departamenti_PCV.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 146_Shkresë_Për zgjedhjen e studentëve për anëtar Bordi.pdf.pdf</i></p>

	<p><i>Evidencë 53_Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit dhe veçanërisht Departamenti i Financë-Kontabilitetit, përgjegjës për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet kordinatorit të programit, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ndërkohë zyra e NJSBC-së përpunon të dhënat e pyetësorëve, të cilët janë të ndarë veç për stafin akademik dhe veç për lëndët që zhvillohen në këtë program. Ky feedback i jep mundësi reflektimi pedagogut të lëndës për problematika që mund të hasen, por edhe më gjerë pasi Përgjegjësi i Departamentit mund të kalojë për diskutim në mbledhje departamenti problematikat e ngritura duke marrë vendime përkatëse në hartim, rishikim dhe përmirësim programi.</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BsC MsC MP.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 131_Pyetësor mbi rezultatet e anketimit të studentëve, të stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin, v.a 2017-2018.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 106_Raporti i vleresimi te brendshem FB 2018-2019.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 75_Email - Mbledhje Departamenti_PCV.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit ka të parashikuar në rregullore (neni 62) të drejtën e studentit për të ankimuar për shkelje të rregullave të provimit dhe vlerësimin e provimit, duke adresuar kërkesën e tij pranë Drejtuesit të Njesisë Kryesore, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i Njesisë Kryesore kur e sheh të arsyeshme i kalon për shqyrtim kërkesën Përgjegjësit të Departamentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit, i cili vë në dijeni dhe personelin akademik të lëndës pas shqyrtimit të kërkesës dërgon te Drejtuesi i Njesisë Kryesore një relacion shpjegues. Në bazë të relacionit Drejtuesi i Njesisë Kryesore vendos për miratim ose refuzim të kërkesës së studentit. Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një</p>

	<p>komision ad-hoc për rishikim të tezës së provimit. Rregullorja parashikon edhe afatet kur ngrihet komisioni dhe kur studenti merr përgjigjen përfundimtare të vlerësimit të tij. Gjatë vizitës në institucion, studentët pohuan se ata kishin mundësi të shikonin provimin, pikët dhe vlerësimin dhe të ankimonin vlerësimin sipas rregullores së Fakultetit të Biznesit.</p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 59_Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Vizita në institucion-takimi me studentët</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Rregulloret e institucionit u mundësojnë studentëve përfaqësimin në organet e UAMD, organet e Fakultetit të Biznesit me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.</i> - <i>Studentët përfshihen në këshillim, sugjerim për rishikim dhe përmirësim të programit të studimit kryesisht bazuar në përpunimin e të dhënave të pyetësorëve nga NJSBC.</i> - <i>Studentët kanë të drejtën e ankimimit për shkelje të rregullave gjatë zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin në provim.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet

Në Statutin dhe rregulloret e UAMD, si dhe në rregulloren e programit të studimit përcaktohen procedurat dhe njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaria mësimore e Fakultetit të Biznesit; koordinatori i programit të studimit; si dhe Drejtorja e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.

<p>ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 81_Rregullore e Sekretarise Mesimore ne FB.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 111_Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 53_Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Financë-Kontabilitetit, që është edhe njësi bazë që mbulon këtë program studimi është përgjegjës për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve nëpërmjet njësi të sipërpërmendura, por edhe stafit të saj akademik. Koordinator i programit të studimit, luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Njësia përgjegjëse për këtë program studimi administron rrjetet sociale për të krijuar një kontakt më të afërt dhe miqësor me studentët, duke ofruar në këtë mënyrë informacion dhe këshilla që lidhen me programin e studimit.</p> <p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 9_Rregullore programi i studimit Banke - Finance.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 53_Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe</p>	<p>GVJ konstaton se shërbimi i këshillimit të karrierës për studentët e UAMD ofrohet nga Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike dhe në nivel program studimi nga Koordinator i Programin e studimit. Specialistët e Sektorit të Këshillimit të Karrierës, këshillojnë studentët për të gjitha hallkat në përgatitjen për tregun e punës. Nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme si: trajnime me fokus përgatitjen për intervistë pune, panairin e punës, evente “histori suksesi”, leksione të hapur (me të ftuar) me përfaqësues nga bota akademike dhe e biznesit, përdorimin e faqes web të UAMD,</p>

<p>orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>etj, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes aktive, të promovimit të studentëve, si dhe të rritjen e mundësive të punësimit të tyre. Programi i studimit Master në Bankë-Financë, ka pjesë të kurrikulës praktikën profesionale, që zhvillohet për 3 muaj, gjatë semetrit të dytë, të vitit të dytë akademik. Specialistët e Sektorit të Këshillimit të Karrierës u kanë ofruar gjithmonë informacion studentëve të këtij program studimi në lidhje me mundësitë për praktika profesionale dhe për punësim. Gjatë vizitës në Institucion, studentët nxorrën në pah, se krahas përfaqësuesve të zyrës së Karrierës, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, u ofron shpesh informacion për mundësi të zhvillimit të praktikave profesionale dhe për punësim.</p> <p><i>Evidencë 28_Njoftime Aktivitete për studentet MSc BF.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 53_Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 83_Rregullore per praktikat mesimore.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 147_Alumni UAMD.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 39_Alumni Network FB Raport.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, ndjek studentët pas diplomimit në funksion të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave në lidhje me shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve (tabela e paraqitur në kriterin 5, të standartit V.4) - Krijimit të rrjetit ALUMNI, për të ndikuar në rritjen e cilësisë së programit të studimit për të ardhmen. <p>Të dhënat statistikore të përpunuara nga Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës i dërgohen Përgjegjësit të Departamentit Financë-Kontabilitetit, të cilat konsiderohen në analizën e punës vjetore të departamentit dhe në përmirësimin e cilësisë së këtij program studimi, dhe programeve të studimit që ofrohen nga ky departament.</p> <p><i>Evidencë 39_Alumni Network FB Raport.pdf.pdf</i></p> <p><i>Materiale shtesë_Tabelat MSC BF_.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 75_Email - Mbledhje Departamenti_PCV.pdf.pdf</i></p>

	<i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf.pdf</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni ka njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaria mësimore e Fakultetit të Biznesit; koordinatori i programit të studimit; si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.</i> - <i>Njësia bazë që mbulon këtë program studimi është gjithashtu përgjegjëse për informim dhe shërbim ndaj studentëve.</i> - <i>Specialistët e Sektorit të Këshillimit të Karrierës dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit u ofrojnë studentëve informacion dhe këshillim për procesin mësimor, praktika profesionale, si dhe orientim në tregun e punës.</i> - <i>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh e përpunon të dhëna mbi cilësinë e punësimit të studentëve dhe ia dërgon Përgjegjësit të Departamentit Financë-Kontabilitetit, të cilat konsiderohen në analizën e punës vjetore të departamentit dhe në përmirësimin e cilësisë së këtij program studimi dhe programeve të studimit që ofrohen nga ky departament.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Institucioni ka në fokus të politikave dhe objektivave të tij zhvillimin e metodave inovative në mësimdhënie në funksion të rritjes së cilësisë së programeve të studimit. UAMD harton periodikisht udhëzues në nivel institucional në shërbim të implementimit të misionit dhe vizionit të Universitetit. “Plani i Zhvillimit Strategjik 2020-2025” shërben si udhëzues për përmbushjen e objektivit kryesor: përmirësimi i performancës në fushat strategjike prioritare si mësimdhënia, kërkimi shkencor, ndërkombëtarizimi, programet e studimit, shërbimet ndaj studentëve dhe burimet njerëzore. Në kuadër të udhëzuesit në nivel institucional, njësiia bazë harton një udhëzues për planin strategjik të njësisë bazë në funksion të realizimit të funksioneve dhe detyrave të saj, ku thelbësore është cilësia e programeve të studimit që ofron.</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 4_Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, 2020-2025.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 11_Plani Strategjik, Fakulteti i Biznesit, 2021-2025.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 12_Plani Strategjik, Departamenti Financë - Kontabilitet, 2021-2025.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBC pranë UAMD mbështetur në rregulloren për këtë njësi synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për të përmbushur standartet e cilësisë të përcaktuar nga UAMD, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet: kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. Institucioni bën monitorim të vazhdueshëm dhe vlerësim periodik të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik, kryesisht nëpërmjet bashkëpunimit të strukturave të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC);




	<ul style="list-style-type: none"> - Përgjegjësi i Departamentit Financë-Kontabilitetit, përgjegjës për programin e studimit. <p>Mekanizmat kryesorë që përdoren janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësor për student (një për stafin akademik dhe një për lëndët e kurrikulës së programit); - Pyetësor për stafin akademik; - Pyetësor për stafit administrative; - Vlerësim i drejtuesit të njësisë kryesore për stafin administrative. <p>Gjithashtu stafi akademik plotëson një Formular vetëvlerësimi për performancën e stafit akademik, në fund të çdo viti akademik, si dhe realizohet një analizë e ecurisë së punës vjetore të Departamentit të Financë-Kontabilitetit.</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 131_Pyetësor mbi rezultatet e anketimit të studentëve, të stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin, v.a 2017-2018.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit të Financë Kontabilitetit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 75_Email - Mbledhje Departamenti_PCV.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në Komisionin e përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë të përbërë nga 11 anëtarë, ka edhe përfaqësues prej studentëve. Gjithashtu edhe GVB gjithmonë ka në përbërjen e tij një student nga programi që akreditohet. Ndërkohë mbështetur në rregulloren e UAMD studentët përfshihen rregullisht në vlerësimin e stafit akademik dhe programit të studimit nëpërmjet plotësimit të formularëve që shpërndan NJSBC, një për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik dhe tjetri për përmbajtjen e lëndës, duke dhënë vlerësimin dhe komentet për përmirësimin e këtij program studimi, si në funksion të mësimdhënies, ashtu edhe të kurrikulës. Studentët kontribuojnë në cilësinë e programit të studimit, edhe nëpërmjet angazhimit në Këshillat studentorë, të cilët mbajnë lidhje të ngushtë me Institucionin, Njësinë kryesore dhe veçanërisht me Njësinë bazë.</p>




	<p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 30. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 157_Komunikim_Pjesëmarrje e studentëve në vendimet e Senatit Akademik.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 131_Pyetësor mbi rezultatet e anketimit të studentëve, të stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin, v.a 2017-2018.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në UAMD, GVJ konkludoi se NJSBC si strukturë përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ia paraqet rezultatet e përpunimit të pyetësorëve Rektorit, Administratorit, KPGSC dhe Senatit Akademik për analiza të mëtejshme. - I dërgon individualisht secilit staf akademik raportin e vlerësimit me pikë pëqindje që rezulton nga përpunimi i pyetësorëve. Ky raport i shkon edhe Përgjegjësit të njësisë bazë për çdo anëtar të departamentit. Përgjegjësi i departamentit pas përpunimit edhe të formularëve të vetëvlerësimit të stafit akademik, bën një analizë vjetore në departament ku merren vendimet përkatëse në funksion të rritjes së cilësisë së programeve të studimit që ofrohen. <p><i>Evidencë 30_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 107_Rezultatet e vlerësimeve të lektorëve nga studentët për Departamentin e F-K 2017 -2018.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 19_Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit të Financë Kontabilitetit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 75_Email - Mbledhje Departamenti_PCV.pdf.pdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të</p>	<p>Referuar vizitës në Institucion, në takimim me stafin akademik të këtij program studimi, GVJ konstatoi gadishmërinë e Institucionit për mbështetje për stafin akademik, si në funksion</p>

<p>marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>të realizimit të një procesi mësimor cilësor (kryesisht në infrastrukturë), ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështjetja financiare për të botuar artikuj në revista me faktor të lartë impakti- Scopus, monografi dhe botime të ngjashme shkencore).</p> <p><i>Evidencë 54_Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 37_Trajnime dhe mobilitete Erasmus +, PAE, v.a 2017-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 61_Financim i botimeve të indeksuara me Scopus.pdf.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni harton periodikisht udhëzues në nivel institucional në shërbim të përmbushjes së misionit dhe vizionit të Universitetit.</i> - <i>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, veçanërisht NJSBC dhe Departamenti i Financë- Kontabilitetit, vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe innovative të personelit akademik, raportojnë në instancat përkatëse sipas rregullores së UAMD, gjë që reflektohet në vendimmarrjet e mëtejshme në kuadër të rritjes së cilësisë së programit të studimit.</i> - <i>Studentët përfshihen në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit të cilësisë, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, pjesmarrjes në komisionet e përhershme, si edhe këshillit studentor.</i> - <i>Institucioni është i angazhuar në nxitjen e personelit akademik në funksion të mësimdhënies dhe kualifikimit shkencor.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se statuti i UAMD (neni 77) përcakton që Institucioni harton politika dhe procedura në funksion të sigurimit të cilësisë. Në rregulloren e UAMD është përcaktuar që Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPSBC) është struktura mbikqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit. Ky komision funksionon në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Statutin dhe në Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë së Institucionit.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 30. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>NjSBC ngrihet me Urdhër të Rektorit dhe ka shtatë anëtarë, nga të cilët, një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD-së, drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, si dhe një student. UAMD ka hartuar planin për zhvillimin strategjik të institucionit ku evidentohet qartësisht që Universiteti është i përkushtuar për të siguruar cilësi dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet procedurave efektive të menaxhimit dhe organizimit të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale të Universitetit. Fokusi i Institucionit për ti bërë këto struktura sa më efektive doli në pah edhe gjatë takimeve të GVJ-së gjatë vizitës në UAMD.</p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i></p>

	<i>Evidencë 4_Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2020-2025.pdf.pdf</i>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UAMD ka realizuar dy procese vlerësimi të jashtëm në kuadër të akreditimit Institucional pranë ASCAL. Vlerësimi i parë u bë në vitin 2017, ku UAMD u akreditua për 4 vite akademike, me vendim të Bordit të Akreditimit nr.10, datë 07.04.2017. Vlerësimi i dytë u bë në vitin 2022, ku UAMD u akreditua përsëri për 4 vite akademike, me vendim të Bordit të Akreditimit nr.18, datë 24.03.2022.</p> <p>Aktualisht UAMD është duke realizuar procesin e vlerësimit të jashtëm për programet të studimit, duke përfshirë edhe programin e studimit Master Shkencor në Bankë-Financë.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Bankë-Financë, është duke u vlerësuar për herë të parë nga ASCAL.</p> <p><i>Evidencë 133_Vendim Nr. 10 datë 07.04.2017 Për Akreditimin e Parë të IAL Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 192_Vendim Nr.18, datë 24.03.2022 i Bordit të Akreditimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 203_Akreditimi i UAMD.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ referuar dokumentave të dorëzuara dhe vizitës në Institucion, konkludon që NJSBC përpunon të dhënat duke llogaritur tregues sasior dhe cilësor në lidhje me cilësinë e procesit mësimor në këtë institucion. Raportet e përgatitur iu dërgohen të gjithë strukturave sipas përcaktimeve në rregulloren e kësaj njësie. Strukturat drejtuese dhe në veçanti Departamenti i Financë-Kontabilitetit përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor.</p> <p><i>Evidencë 30. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 2_Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i>

	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni harton politika dhe procedura në funksion të sigurimit të cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregullatore.</i> - <i>UAMD ka hartuar planin për zhvillimin strategjik të institucionit ku evidentohet përkushtimi ndaj cilësisë.</i> - <i>NJSBC përgatit raporte me tregues sasior dhe cilësor, dhe ua dërgon strukturave përkatëse, të cilat marrin vendime në funksion të përmirësimit të cilësisë.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dërguar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstaton se në UAMD aktiviteti i NJSBC-së ka një sistem raportimi vjetor dhe kryesisht në formën e një raporti analize mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, si dhe kurrikulën e çdo programi studimi.</p> <p>Aktualisht pyetësori është uniform për të gjitha programet e studimit që ofron UAMD dhe në varësi të pyetësorit, plotësohen fizikisht dhe online. Aktualisht Institucioni është duke inkorporuar plotësimin e pyetësorit për stafin akademik dhe lëndët në sistemin “Pitagora” në mënyrë që të plotësohet prej të gjithë studentëve, si dhe të rritet siguria për vërtetësinë e të dhënave. Vlerësimet e NJSBC raportohen në strukturat drejtuese të përcaktuara në rregulloren e njësisë. Ato janë pjesë e informacionit të paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit të institucionit si dhe përdoren nga njësitë bazë në analizën vjetore përkatëse. Njësitë kryesore të UAMD ngrenë GVB të cilët mundësojnë hartimin e Raportit Vjetor të Vetëvlerësimit të Brendshëm për çdo njësi. Në këtë raport analizohet ecuria e</p>

<p>vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>procesit mësimor, kërkimor shkencor dhe ndërkombëtarizimi, në rang njësie kryesore, njësisish bazë si edhe programe studimi.</p> <p><i>Evidencë 30_Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 106_Raporti i vleresimi te brendshem FB 2018-2019.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 107_Rezultatet e vlerësimeve të lektorëve nga studentët për Departamentin e F-K 2017 -2018.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezulton se në mbledhjet e departamentit në fund të çdo viti mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve, pyetësorët për personelin akademik dhe joakademik si dhe formularët e vetëvlerësimit. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të UAMD sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Mbështetur në analizën vjetore të njësisive bazë, përgatitet edhe raporti i analizës vjetore për njësitë kryesore. Në këtë raport vjetor të vetëvlerësimit të Fakultetit të Biznesit, përcaktohen qartë objektivat kryesore në lidhje me procesin mësimor, kualifikimin shkencor dhe ndërkombëtarizimin. Ky raport përmban informacion të gjerë sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesin mësimor, vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, të cilësisë të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor, si dhe rekomandime e sugjerime për të ardhmen.</p> <p><i>Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022.pdf.pdf</i></p>
	<p><i>Evidencë 75_Email - Mbledhje Departamenti_PCV.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 107_Rezultatet e vlerësimeve të lektorëve nga studentët për Departamentin e F-K 2017 -2018.pdf.pdf</i></p>




	<p><i>Evidencë 106_Raporti i vleresimi te brendshem FB 2018-2019.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në takimet me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë që mbulon këtë program studimi, GVJ konstatoi se përdoren disa procedura periodike për vlerësimin e realizimit, të mbarëvajtjes dhe të cilësisë së programit të studimit në nivel Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> - NJSBC përpunon pyetësorët e studentëve duke bërë një raportim me vlerësim me pikë përqindje për stafin akademik dhe kurrikulën e programit të studimit; - Drejtuesi i Departamentit të Financë-Kontabilitetit bazuar në raportin e NJSBC-së si dhe raportin e kordinatorit shkencor të departamentit që përpunon të dhënat e vjela nga formularët e vetëvlerësimit të stafit akademik, realizon analizën vjetore të veprimtarisë së departamentit, ku merren vendime për ndryshime në funksion të përmirësimit të cilësisë. - Fakulteti i Biznesit harton raportin vjetor të vetëvlerësimit në nivel njësie kryesore lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, të cilësisë të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor, si dhe rekomandime e sugjerime për të ardhmen. <p>Gjithashtu në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe Institucioni bëhen vëzhgime rastësore të zhvillimit të mësimin në auditor (më shpesh për pedagogët e rinj).</p> <p><i>Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 107_Rezultatet e vlerësimeve të lektorëve nga studentët për Departamentin e F-K 2017 -2018.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 106_Raporti i vleresimi te brendshem FB 2018-2019.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 56_Vendimi i përcaktimit të kordinatorit të kërkimit shkencor.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta</p>	<p>UAMD në kuadër të vlerësimit të cilësisë për programet e studimit përdor mekanizimat e mëposhtëm kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësor për studentët (një për stafin akademik dhe një për lëndët e kurrikulës së programit); - Pyetësor për personelin akademik; - Pyetësor për personelin administrativ;

<p>vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim i drejtuesit të njësisë kryesore për personelin administrativ. <p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe veçanërisht informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në Institucion GVJ konstatoi se pyetëtori për feedback-un e rrjetit ALUMNI (ish studentë) në lidhje me cilësinë e procesit mësimor dhe programet e studimit, fokusohet kryesisht në vjeljen e informacionit në lidhje me punësimin e tyre, si dhe përdorimin si urë lidhëse për realizimin e praktikave apo punësimin e studentëve aktualë.</p> <p><i>Evidencë 131_Pyetësor mbi rezultatet e anketimit të studentëve, të stafit akademik dhe administrativ mbi Institucionin, v.a 2017-2018.pdf.pdf</i></p> <p><i>Tabelat MSC BF_.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 72_Pyetësor - Përzgjedhja e studimeve Bsc Master pranë UAMD .pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 74_Pyetësor Vlerësimi i studentëve pas përfundimit të studimeve në BsC MsC MP.pdf.pdf</i></p> <p><i>Materiale shitesë_Tabelat MSC BF_.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 39_Alumni Network FB Raport.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 30. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 164_Raportim lektore_Mbi sigurimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë.pdf.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UAMD ka një sistem raportimi që konsiston në llogaritje treguesish sasior dhe cilësor, bazuar në përpunimin e pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, si dhe kurrikulën e çdo programi studimi.</i> - <i>Në nivel njësie bazë dhe njësie kryesore bëhen analiza vjetore të punës mësimore dhe kërkimore bazuar në përpunimin e pyetësorëve, formularët e vetëvlerësimit, duke nxjerrë në pah arritjet dhe rekomandimet për të ardhmen.</i> - <i>Institucioni në kuadër të vlerësimit të cilësisë përdor një sërë metodash të tërthorta, megjithatë <u>GVJ sugjeron përfshirjen</u></i>




	<i>më aktive të rrjetit ALUMNI në funksion të përmirësimit të kurrikulës së këtij program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Institucioni ka ngritur strukturat që garantojnë sigurimin e cilësisë konform legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse. Këto struktura janë ngritur në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Struktura më e aktive në këtë proces është NJSBC, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe veçanërisht me njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardet e cilësisë së UAMD, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Strukturat e sigurimit të cilësisë kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Referuar rregullores së UAMD në këto struktura përfshihen personel akademik efektiv, personel ndihmës akademik, studentë si dhe aktorë të jashtëm si lektorë të ftuar apo bashkëpunëtorë në projekte të ndryshme, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UAMD, në NJSBC, në Bord Administrimi, si dhe në hartimin e RVB për vlerësim të jashtëm pranë ASCAL.</p> <p><i>Evidencë 30. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>RVB Msc Bankë- Financë.pdf.pdf</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, në statutin dhe rregulloren e UAMD, janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.</p> <p>Në rregulloret e NJSBC, Fakultetit të Biznesit dhe të Departamentit të Financë-Kontabilitetit janë përcaktuar përgjegjësitë përkatëse në funksion të sigurimit të cilësisë. Ndërkohë në çdo grup pune të ngritur në kuadër të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm përcaktohen detyrat për çdo anëtar të grupit të punës. Detyrat janë të përcaktuara qartë edhe për studentët kur këta janë të përfaqësuar në këto grupe vlerësimi. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që studentit të angazhuar në GVB për këtë program studimi, i ish-in përcaktuar detyrat përkatëse që do të kishte në funksion të përgatitjes së RVB.</p> <p><i>Evidencë 30. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13_Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 15_Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka për detyrë monitorimin në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. NJSBC ka përfaqësues pranë Fakultetit të Biznesit, por nuk është ngritur akoma NJSBC e Fakultetit të Biznesit sic parashikohet në Statut dhe Rregullore të UAMD, gjë që do të lehtësonte punën e NJSBC në nivel Institucioni, si dhe do të rriste nivelin e efikasitetit. Struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë janë edhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit dhe Fakulteti i Biznesit, si njësi bazë dhe kryesore që ofrojnë këtë program studimi. Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit, si staf drejtues, Koordinatori i programit të studimit, Koordinatori shkencor i departamentit janë personeli akademik i angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë. Ndërkohë pjesë e këtij vlerësimi janë edhe personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, si pjesë aktive e analizës vjetore të departamentit dhe komenteve e sugjerimeve</p>




	<p>në funksion të përmirësimit të kurrikulës. Në vlerësimin e jashtëm të këtij program studimi janë angazhuar në GVB pesë anëtarë: tre personel akademik, një personel ndihmësakademik dhe një student.</p> <p><i>Evidencë 30. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 70_Ngritja e grupeve të punës për akreditimin e programeve të studimit.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar RVB si dhe informacionit të vjelë gjatë takimit me stafin drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi GVJ konstaton se personeli akademik përfshihet në mënyrë aktive në proceset e vlerësimit të programeve të studimit, duke respektuar të drejtat dhe integritetin akademik të secilit prej tyre dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Përzgjedhja e anëtarëve të grupeve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm bëhet me vendim departamenti, me propozim nga anëtarët e këtij departamenti.</p> <p><i>Evidencë 70_Ngritja e grupeve të punës për akreditimin e programeve të studimit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në funksion të rritjes së cilësisë janë lidhur një sërë marrveshesh në nivel Institucioni dhe në nivel njësie kryesore. Këto marrveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, mundësojnë organizmin e aktiviteteve të ndryshme si trajnime dhe workshop-e, leksione të hapura, organizimin e panairit të punës; etj. Gjithashtu mundësojnë realizimin e praktikave profesionale për studentë, si dhe shpesh luajnë rol aktiv në punësimin e studentëve.</p> <p><i>GVJ sugjeron që Departamenti i Financë-Kontabilitetit, duhet të realizojë aktivitete me Institucione publike dhe private me të cilat ka marrveshje bashkëpunimi, të tipit "Tavolinë e rrumbullakët", "Workshop", me qëllim që të marrë feedback-un e tyre në kuadër të rritjes së cilësisë së programit të studimit Master Shkencor në Bankë-Financë dhe bërjen e tij një program më tërheqës në treg, në kushtet e rënies së numrit të studentëve.</i></p> <p>Departamenti i Financë-Kontabilitetit realizon plotësimin e një pyetësori me rrjetin ALUMNI për të shprehur opinionin e tyre në</p>

	<p>lidhje me cilësinë e programeve të studimit të ofruara nga departamenti i financës. Megjithatë mbas konsultimit të këtij pyetëtori, në lidhje me përmbajtjen e tij GVJ mendon që pyetëtori duhet të jetë shumë më tepër i fokusuar në cilësinë e kurrikulës, në funksion të mësimdhenies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të forcohet komunikimi dhe bashkëpunimi me rrjetin ALUMNI, veçanërisht në funksion të rritjes së cilësisë së programit të studimit- përmirësimit të kurrikulës dhe të procesit mësimor.</i></p> <p><i>Evidencë 27_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës dhe Fakultetit të Biznesit.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 33_Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel institucioni.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 157_Komunikim_Pjesëmarrje e studentëve në vendimet e Senatit Akademik.pdf.pdf;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni ka ngritur strukturat që garantojnë sigurimin e cilësisë në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë, të cilat kanë në përbërje të tyre personel akademik, ndihmësakademik dhe studentë.</i> - <i>Përzgjedhja e anëtarëve të strukturave të vlerësimit të cilësisë bëhet në respekt të integritetit akademik, duke shmangur diskriminimin apo pabarazinë.</i> - <i>Anëtarët e njërive të sigurimit të cilësisë kanë të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.</i> <p><i>GVJ sugjeron që pjesë aktive e procesit të vlerësimit të cilësisë të bëhen edhe bashkëpunëtorë të jashtëm të Institucionit, veçanërisht përfaqësues të rrjetit ALUMNI dhe përfaqësues të institucioneve publike dhe private me të cilat Institucioni ka marrveshje bashkëpunimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, si dhe të marrë gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstaton se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen Web të tij, të të gjitha veprimtarive (statute, rregullore) përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti.</p> <p>Informacioni në nivel njësie bazë përcillet nga NJSBC. Ndërkohë që njësia bazë organizon analizën e punës vjetore të departamentit, që bazohet në raportin e NJSBC-së dhe përpunimin e formularëve të vetëvlerësimit të personelit akademik. Studentët informohen përmes njësisë bazë për problematikat që mund të shfaqen në lidhje me cilësinë.</p> <p><i>Evidencë 30. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022.pdf</i></p> <p>www.uamd.edu.al</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB-së dhe vizitën në UAMD, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen web të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti. GVJ konsultoi faqen web të Institucionit dhe konstatoi se publikimet aktuale në lidhje me rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>Rezultatet që dalin nga përpunimi i pyetësorëve nga NJSBC ju dërgohen individualisht secilit personel akademik, si dhe përgjegjësit të njësisë bazë. Njësia bazë bën analizën e punës vjetore të departamentit duke përcaktuar dhe objektivat për të ardhmen. Analizë e punës vjetore bëhet edhe në nivel njësie kryesore, duke përcaktuar objektivat për njësinë kryesore, njësitë bazë si edhe programet respektive që ofrohen.</p> <p><i>Evidencë 30. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p>

	<p><i>Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 98_Analiza Vjetore e FB.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë, mbas marrjes së raportit nga NJSBC dhe përpunimit të formularëve të vetëvlerësimit nga koordinatori shkencor i departamentit, realizon analizën e punës vjetore të departamentit duke vendosur dhe objektivat për të ardhmen. Analizë e punës vjetore bëhet edhe në nivel njësie kryesore, duke përcaktuar objektivat për njësinë kryesore, njësitë bazë si edhe programet respektive që ofrohen.</p> <p><i>GVJ nga informacioni i dokumentacionit shoqërues nuk konstatoi ndonjë plan masash specifik, për përmirësimin e mangësive apo dobësive të evidentuara. Gjatë takimeve në Institucion, na u sollën praktika se si ishte proceduar kur personeli akademik kishte rezultuar me vlerësim më të ulët se 70%, apo kur kishte patur keqkuptim të pyetjes nga studentët që kishin plotësuar pyetësorët.</i></p> <p><i>Evidencë 30. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pd.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 98_Analiza Vjetore e FB.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB-së dhe vizitën në UAMD, GVJ konstaton që Institucioni e ka fokusuar kryesisht monitorimin e cilësisë nëpërmjet evidentimit të problematikave nga NJSBC dhe Njësia Bazë. Bazuar në raportet e përgatitur nga NJSBC dhe analizës vjetore të departamentit të Financë-Kontabilitetit dhe njësive të tjera bazë, Fakulteti i Biznesit harton periodikisht çdo vit Raportin e Vetëvlerësimit të Brendshëm. Në këtë raport analizohet ecuria e punës së çdo njësie bazë dhe program studimi të Fakultetit, në kuadër të përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>

	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ iu konfirmua nga drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, angazhimi për të përmirësuar programin e studimit në kuadër të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë, duke u bazuar në problematikat e ndeshura si dhe ndryshimeve të kërkesave të tregut. Ky program ka pasur riorganizime të vogla, nën masën 20%, në vitin akademik 2020-2021 për ndryshime në kredite, dhe ndryshim lënde (lënda “Drejtimit Operacionesh” është zëvendësuar me lëndën “Drejtimit i Avancuar i Projekteve”) dhe në vitin akademik 2021-2022 me ndryshim lënde (lënda “Ekonomiks Menaxherial” është zëvendësuar me lëndën “Ekonometri”).</p> <p><i>Evidencë 32_Analiza Vjetore e departamentit Financë Kontabilitet v.a 2021-2022.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 98_Analiza Vjetore e FB.pdf.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 175_Analiza e ecurisë së programit të studimit MSc BF.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në Institucion GVJ konstaton se veprimtaritë periodike me personelin dhe studentët në funksion të këtij kriteri lidhen me aktivitete informuese me studentë, publikime në faqen Web të UAMD, platformën Pitagora, klasat e krijuara në Google Classroom dhe Teams, si dhe publikime në rrjetet sociale të administruara nga departamenti i Financë-Kontabilitetit, me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 39_Alumni Network FB Raport.pdf.pdf</i></p> <p><i>www.uamd.edu.al (rubrika: transparenca)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Kuadri rregullator i institucionit parashikon publikimin në faqen web të tij, të të gjitha veprimtarive përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i> - <i>Njësia bazë realizon analizën e punës vjetore dhe më pas njësia kryesore publikon raportin e Vetëvlerësimit për njësitë</i>




	<p><i>bazë dhe programet e studimit duke përcaktuar objektivat për të ardhmen.</i></p> <p><i>- Drejtuesit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore në sajë të problematikave të ndeshura dhe ndryshimet në tregun e punës angazhohen në funksion të përmirësimit në vijimësi të cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Bankë-Financë”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Infrastruktura dhe pozicionimi aktual i godinës 2 ku zhvillon aktivitetin ky program studimi, ofron mundësi studentëve, personelit akademik dhe ndihmësakademik, për zgjerim kampusi dhe krijim ambjentesh të gjelbërta dhe shlodhëse;
2. Institucioni motivon stafin akademik, duke i mbështetur financiarisht për publikimin e artikujve shkencorë me faktor të lartë impakti, në funksion të rritjes së nivelit të tyre kërkimor-shkencor, e si rrjedhim edhe të cilësisë së programeve të studimit që ofrohen;
3. Komunikimi dhe bashkëpunimi i ngushtë i studentëve të këtij program studimi, me personelin akademik të Departamentit të Financë-Kontabilitetit;
4. Përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse bëhet kryesisht nëpërmjet platformave online. GVJ e gjen me shumë vend, në kuadër të këtij program studimi, shtimin e numrit të titujve online në të cilin kanë akses studentët, pasi rrit cilësinë e programit, si dhe mundësinë e përdorimit të teknikave koherente dhe inovative në këtë proces mësimor-kërkimor;

b. Pika të dobta:

1. Numër i ulët i personelit akademik të kategorisë “Profesor” të angazhuar në këtë program studimi. Përgatitja akademike dhe kërkimore-shkencore, si dhe eksperiencia e kësaj

kategorie personeli akademik janë elementë kyc në funksion të cilësisë së programit të studimit; *(Standarti II.2, kriteri 1)*

2. Mungesë fleksibiliteti në ndarjen e vlerësimit sipas formave të kontrollit të dijeve; *(Standarti II.3, kriteri 4)*
3. Kurrikula përmban shumë lëndë nga nënfusha të tjera të ekonomisë, duke ndikuar cilësinë e formimit për studentët që ndjekin këtë profil masteri; *(Standarti II.4, kriteri 2 dhe kriteri 4)*

Rekomandime

1. GVJ sugjeron rritjen e numrit të stafit akademik nga kategoria “Profesor”. Në komentet për Draft RVJ-në nga Institucioni është evidentuar se gjatë këtij viti akademik, stafi akademik i kategorisë “Profesor” i angazhuar në këtë program studimi ka shkuar në katër, ndërkohë që dy të tjerë janë në process për marrjen e titullit;
2. GVJ sugjeron të ofrohet fleksibilitet për pedagogun e lëndës në ndarjen e pikëve për vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar, në respektim të përmbajtjes së lëndës, metodave të mësimdhënies së përdorur, si dhe të lirisë akademike;
3. Kurrikula duhet të rishikohet në funksion të drejtimit të Masterit, si për sa i takon Lëndëve të formimit bazë- Kategoria A, ashtu edhe për lëndët e Kategorisë B dhe C ku ka të përfshira shumë lëndë të profilit Kontabël;

Evaluation’s conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in “Banking and Finance”

a. Strengths and affirmations:

1. The infrastructure and the position of Building no: 2, where this study program takes place offers opportunities for students, academic and non-academic staff, for campus expansion and creation of green and relaxing environments;
2. The Institution motivates the academic staff, supporting them financially for the publication of scientific articles with high impact factors, in order to increase their research and scientific level, and therefore to increase the quality of the study programs offered;
3. Communication and close collaboration between the students that attend this study program and the academic staff of the Finance and Accounting Department;

4. The updating of the Main and Additional literature is mainly done through online platforms. GVJ finds it very appropriate, for this study program, to increase the number of online titles to which students have access, as it increases the quality of the program, as well as the possibility of using coherent and innovative techniques in this teaching and research process;

b. Weaknesses:

1. Low number of academic staff of the "Professor" category engaged in this study program. The academic, scientific, and research experience of this academic staff category are key elements in the quality of this study program; *(Standard II.2, criteria 1)*
2. Lack of flexibility in the continuous evaluation, according to the forms of knowledge control; *(Standard II.3, criteria 4)*
3. The curriculum contains many subjects from other fields of economy, affecting the quality of this master's program profile; *(Standard II.4, criteria 2 & 4)*

Recommendation

1. GVJ suggests increasing the number of academic staff from the "Professor" category. *In the comments on the Draft RVJ from the Institution, it was noted that during this academic year, the academic staff of the "Professor" category engaged in this study program has increased to four, while the other two are in the process of obtaining the title.*
2. GVJ suggests that flexibility be offered to the lecturer in the determination of points for continuous evaluation, concerning the content of the subject, the teaching methods used, as well as in respect of academic freedom;
3. The curriculum should be reviewed according to the Master's profile, both for the Modules of Basic Program - Category A, as well as for the subjects of Category B and C where many courses of the accounting profile are included;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X